

Anette Brunovskis dhe Rebecca Surtees

Ta lësh të kaluarën mbrapa? Kur viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën

Raport përmbledhës

Një studim bashkëpunimi ndërmjet FAFO AIS (Oslo) dhe
Institutit NEXUS (Uashington)



Anette Brunovskis dhe Rebecca Surtees

**Ta lësh të kaluarën mbrapa?
Kur viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën**
Raport përmbledhës

Një studim bashkëpunimi ndërmjet FAFO AIS (Oslo) dhe
Institutit NEXUS (Uashington)

© Fafo

ISBN 978-82-7422-903-7 (paper edition)

ISBN 978-82-7422-904-4 (web edition)

ISSN 0801-6143

Printed in Norway by: Allkopi AS

Pasqyra e lëndës

Pasqyra e lëndës	3
Hyrje	4
Pjesa I: Hyrje.....	5
1. Fokusi i raportit përmbledhës.....	5
2. Metodologjia	6
3. Kategoritë konceptuale – pranimi dhe refuzimi i ndihmës	7
Pjesa II: Rrethanat personale që çojnë në refuzimin e ndihmës.....	8
4. Kur ndihma pengon emigrimin	9
5. Ndërveprimi me familjen kur vendosin për ndihmën	11
6. Viktimat që nuk kanë nevojë për ndihmë.....	13
Pjesa III: Vështirësitë në sistemin e ndihmës	17
7. Probleme të informacionit dhe komunikimit	18
8. Organizimi i ndihmës si një arsye për të refuzuar.....	21
9. Ofruesit e shërbimit dhe viktimat – kush refuzon kë?.....	24
Pjesa IV: Konteksti shoqëror dhe përvoja personale si pengesa për pranimin e ndihmës.....	28
10. Besimi	29
11. Stigma dhe përjashtimi.....	31
12. Identifikimi me rolin e viktimës.....	33
Përfundimi dhe rekomandimet	38

Hyrje

Ky studim u mendua, pasi në studimin e mëparshëm vumë re, se disa viktimat refuzuan ndihmën e ofruar dhe në dispozicionin e tyre. Kjo nuk ishte vetëm një çështje në vetvete, por një kuptim sa më i mirë i kësaj sjelljeje mund të nxirrte në pah kushtet dhe sfidat që gratë dhe vajzat përballen pas trafikimit, përfshirë këtu çfarë mund të lehtësojë tranzicionin pas trafikimit. Ne i jemi mirënjohës Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë që ra dakord të financonte projektin tonë. Gjithashtu, zbuluam se kjo temë u mirëprit nga shumë ofrues shërbimesh. Vlerësojmë ndarjen bujare të informacionit nga ana e tyre, si dhe diskutimin e sinqertë mbi sfidat dhe pengesat që ata hasin. Ne, gjithashtu, i falënderojmë për kohën dhe përpjekjet e tyre që na lehtësuan të arrijmë një gamë të gjerë personash të trafikuar, përvojat e të cilave përbëjnë dhe bazën e këtij studimi. Nuk i kemi renditur këto organizata në mënyrë individuale pasi nuk dëshirojmë që gjetjet tona të shoqërohen më në mënyrë të padrejtë me ndonjë program, organizatë apo vend. Gjetjet tona janë pasqyruese të situatës së përgjithshme dhe organizatat që na ndihmuan duhet të përgëzohen si për transparencën e tyre ashtu dhe për përkushtimin që kanë treguar për të trajtuar këtë çështje. Për më tepër, do të dëshironim të falënderonim gratë dhe vajzat e trafikuar dhe personat e prostitucionit në rrugë, të cilët ishin të gatshëm të ndanin detaje të përvojave të tyre, si një përpjekje për të përmirësuar kushtet dhe mundësitë për persona të tjerë të trafikuar. Pa pjesëmarrjen e tyre kurajoze dhe bujare, ky studim nuk do të ishte bërë i mundur. Ne shpresojmë të kemi përfaqësuar në mënyrë të drejtë qëndrimet dhe përvojat e tyre.

Ne kemi përfituar gjithashtu nga ndihma e kolegëve. Laura Mitchell ishte në qendër të mbledhjes së të dhënave duke kryer punën në terren në Serbi dhe Shqipëri. Guri Tyldum ishte në qendër të hartimit të projektit. Në Serbi, ekipi i punonjësve në terren i Qendrës Kundër-Trafikimit – Jelena Milic, Borislav Djurkovic, Stefan Dimitrijevic dhe Suzana Vukoje – punuan si asistentë në terren, duke intervistuar 20 gra, vajza dhe tranvestitë që prostituonin në rrugë në Beograd; këtë informacion nuk do të mund ta kishim marrë pa ndihmën e tyre kompetente. Ne gjithashtu dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen Slavica Stojkovic, Valbona Lenja dhe Stella Rotaru nga misionet e IOM-it në Serbi, Shqipëri dhe Moldavi, të cilët na ndihmuan jashtë mase duke organizuar punën tonë në terren. Për më tepër, kemi pasur mbështetjen e domosdoshme nga grupi ynë i përkthyesve shumë kompetent – Milena Markovic, Daniela Hasa, Aljona Thaci, Julian Hasa dhe Alina Legcobit.

Së fundi, dëshirojmë të falënderojmë May-Len Skilbrei të Fafo-s, Instituti për Studimet Ndërkombëtare të Aplikuara dhe Stephen Warnath të Institutit NEXUS për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe rishikimin e kujdesshëm të informacionit në studim.

Pjesa I: Hyrje

1. Fokusi i raportit përmbledhës

Ky studim zbulon pse dhe në çfarë rrethanash disa viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën. Në të njëjtën kohë, ai trajton gjithashtu rrethanat e shumëllojshme me të cilat përballen gratë dhe vajzat e trafikuar, kur ato ndeshen me sistemet e ndihmës si në vendin e tyre ashtu dhe jashtë. Arsye, se pse viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën, tregojnë shumë për kufizimet dhe sfidat me të cilat përballen ato që zgjedhin për ta pranuar këtë ndihmë. Për këtë arsye, ky raport ka si qëllim që të kontribuojë në njohjen e kushteve dhe nevojave të viktimave të trafikimit në përgjithësi. Ne kemi parë se, ndërsa shumë viktimave nuk u ofrohet asnjëherë ndihma, disa nga personat e trafikuar që *u është* ofruar ndihma, zgjedhin që të heqin dorë nga ndihma e disponueshme për ata. Bazuar në këtë, pyetjet kryesore për kërkimin tonë ishin si më poshtë:

- Cilat janë arsyet mbrapa atyre vendimeve për të refuzuar ndihmën?
- Çfarë ndodh si rrjedhojë e refuzimit të ndihmës?
- A ka arsye të refuzimit, që mund të adresohen me qëllimin që më shumë viktimat, dhe mbase grupe të tjera viktimash, të përfitojnë gjithashtu nga ndihma?

Qëllimi ynë nuk ishte të vlerësonim përpjekjet dhe aftësinë e ndonjë organizate në veçanti apo individëve që punojnë në këtë fushë kaq sfiduese, por kishte më shumë të bënte me përshkrimin e sfidave që përballen, si ofruesit e shërbimeve ashtu edhe gratë e vajzat e trafikuar në jetën e tyre pas trafikimit, përfshirë këtu edhe bashkëveprimin midis tyre. Raporti ynë ka si synim që të kontribuojë në një diskutim se si është e organizuar ndihma për viktimat e trafikimit dhe të ofrojë disa ide se çfarë mund të bëhet për të plotësuar më mirë nevojat e popullatës së ndryshme, e cila i përket kategorisë së viktimës së trafikimit.

Kjo është një përmbledhje e gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të raportit “*Të lësh të kaluarën pas? Kur viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën.*”¹ Qëllimi i këtij raporti të shkurtuar është që të përmbledhë faktorët kryesorë që ndikuan në vendimet e viktimave të trafikimit për të refuzuar ndihmën, si edhe të japë disa rekomandime praktike që mund të përdoren nga profesionistët e anti-trafikimit dhe nga ofruesit e shërbimeve.

¹ Raporti mund të shkarkohet nga adresa: <http://www.faf.no/pub/rapp/20040/20040.pdf>. Citimi për raportin e plotë është: Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Leaving the past behind? When victims of trafficking decline assistance*. Faf AIS (Oslo) dhe NEXUS Institute (Vjena).

2. Metodologjia

Çështja u trajtua nëpërmjet një projekti kërkimor cilësor, duke mbledhur të dhëna nga viktimat e trafikimit dhe informatorët kyç, që punonin në fushën e kundër-trafikimit. Puna në terren u krye gjatë muajve Prill dhe Nëntor të 2006-ës. Terrenet ishin në Shqipëri dhe Moldavi (vendet burim); Serbi (vendi tranzit/destinacioni/burim). Intervistat u bënë në kryeqytete si dhe në fshatra e qytete të përzgjedhura. Secili vend u vizitua dy herë për një javë; puna e dytë në terren përfshiu ri-intervistimin e të intervistuarve dhe arritjen e intervistuesve dhe vendeve të reja të identifikuara gjatë vizitës së parë.

Kampioni i intervistës: 52 gra dhe vajza të trafikuar dhe në rrezik trafikimi; 90 individë qeveritarë dhe jo-qeveritarë që punojnë në programet e ndihmës	
Numri i viktimave të trafikimit të intervistuar	39
Personat që prostituojnë në rrugë, statusi i trafikimit i panjohur	13
Numri i viktimave të trafikimit të intervistuar dy herë	7
Kishte pranuar ndihmën në kohën e intervistës	30
Asnjëherë të identifikuara, asnjëherë nuk u është ofruar ndihmë	7
Të identifikuara dhe u është ofruar ndihmë, por i refuzuan të gjitha	2
Informatorë kyç në fushën e KT	90
Informatorë kyç të intervistuar të paktën dy herë	11

Rekrutimi i të intervistuarve dhe intervistat:

Hapi 1: Intervista me informatorë kyç në organizatat e ndihmës dhe aktorë të tjerë të përfshirë në punën kundër-trafikimit: 35 organizata në tre vende, me një gamë të gjerë përvoja në ndihmën ndaj viktimave

Hapi 2: Rekrutimi i viktimave të trafikimit si të intervistuar nëpërmjet dhjetë organizatave të ndihmës. Në bëmë një zgjedhje të ndërgjegjshme për të mos rekrutuar të intervistuar jashtë këtyre kanaleve (si për shembull nga qendrat e shërbimeve sociale, grupet e komunitetit dhe aktorë të tjerë lokalë) për shkak të rrezikut të ekspozimit të viktimave si të trafikuar në komunitetin e tyre.

Hapi 3: Intervista me viktimat duke ruajtur etikën. Për të siguruar një miratim të informuar, intervistuesve të mundshme iu dha informacion i shkruar për projektin në gjuhën kombëtare. Informacioni u përsërit me gojë si një hyrje gjatë çdo interviste, dhe në fund të çdo interviste u la kohë për ndonjë pyetje që të intervistuarat mund të kenë dhe për t'u shpjeguar se si mund të na kontaktonin, nëse të intervistuarat do të kishin ndonjë shqetësim më vonë.

Ndërmjet organizatave të ndryshme ka pasur ndryshime thelbësore në lidhje me gatishmërinë e tyre për të pyetur përfitueset, nëse ato dëshironin të merrnin pjesë në studim si dhe në lidhje me gatishmërinë e tyre për të folur hapur për punën dhe përvojat me viktimat që refuzonin shërbimet. Ndoshta jo çuditërisht, organizatat që ishin më pak transparente për punën e tyre ishin edhe më pak të gatshme për t'u kaluar përfituesve informacionin mbi projektin studim, në fakt duke marrë edhe vendime për përfitueset, në vend që t'u lejonin atyre të vendosnin vetë. Është e vështirë të thuhet nëse të dhënat tona do të ishin konsiderueshëm ndryshe, nëse aksesin ndaj të intervistuarve do të ishte i shpërndarë në mënyrë më të barabartë ndërmjet organizatave të ndryshme dhe modeleve të kujdesit. Gjithsesi, ky lloj aksesit i pabarabartë ndaj të intervistuarve duhet të merret parasysh në studimet e trafikimit në përgjithësi. Gjithashtu, ngre çështjen se deri në çfarë mase duhet një organizatë të kontrollojë dhe përcaktojë arsyeshëm ndërveprimin e përfituesve me botën e jashtme, përfshirë dhe pjesëmarrjen në studim.

3. Kategoritë konceptuale – pranimi dhe refuzimi i ndihmës

Kur e filluam studimin, përcaktuam, se cilat, për ne, ishin disa kategori të “pranimit” dhe “refuzimit” të ndihmës. Ne jemi të ndërgjegjshëm, se çështja e refuzimit është më shumë e ngjyruar sesa shpesh paraqitet – vetëm disa viktima ose e pranojnë krahëhapur ndihmën ose e refuzojnë atë në mënyrë të padiskutueshme. Kështu që kërkuam të kapnim këtë kompleksitet në kategoritë tona.

- “Pranimi i ndihmës” i referohet personave që vullnetarisht kishin marrë një formë të shërbimit. Pranimi i ndihmës nuk nënkupton pranimin e të gjithë ndihmës së ofruar por i referohet edhe përzgjedhjes së shërbimeve që përmbushin nevojat e viktimës. Viktima mund të zgjedhë që të marrë një ndihmë financiare ri-integruese dhe kurse profesionale por të mos qëndrojë në një strehëz sepse dëshiron të kthehet e të jetojë në shtëpi.
- “Refuzimi i ndihmës” i referohet çdo lloj situatë kur një viktime i janë ofruar ose e dinte që gëzon të drejtën për shërbimet por i refuzon ato. Disa viktima mund të refuzojnë krejtësisht ndihmën, duke zgjedhur që të klasifikohen si një emigrant i paligjshëm ose si prostitutë sesa si viktimë trafikimi. Viktimat, gjithashtu, mund të refuzojnë pjesërisht ndihmën – për shembull, të pranojnë ndihmën në lidhje me rregullimin e dokumentave ose udhëtimit por të refuzojnë ndihmën e mëtejshme kur të kthehen në shtëpi.

Vendimet për pranimin dhe refuzimin e ndihmës nuk janë në përgjithësi një vendim “ose/ose”, ku viktimat shpesh përzgjedhin dhe refuzojnë shërbimet nga një sërë alternativash të disponueshme në vendin e destinacionit, tranzitit ose origjinës, për një periudhë prej disa javësh, muajsh dhe madje vitesh. Ka klasifikime; pak viktima mund të kategorizohen si “pranuese” dhe “refuzuese”. Viktimat morën vendime të ndryshme në faza të ndryshme të jetëve të tyre pas-trafikimit, në varësi të zhvillimit të situatës së tyre personale dhe në varësi të nivelit të kërkuar të angazhimit nga format e ndryshme të ndihmës. Kjo sugjeron një proces shumë më të ndërlikuar të vendim-marrjes sesa shpesh paraqitet. Si i tillë, kur flasim për “refuzimin e ndihmës” është më e përshtatshme të flasësh për një vazhdimësi vendimesh përgjatë së cilës pjesa më e madhe e viktimave lëvizin. Për më tepër, ekziston një kompleksitet i madh që rrethon procesin e vendim-marrjes, shërbimet e ofruara dhe nevojat e interesat personale të viktimës.

Duke pasur parasysh se vendimet e pranimit dhe refuzimit të ndihmës gjenden përgjatë një vazhdimësie, ne kemi identifikuar tre kategori kryesore të arsyeve për refuzimin e ndihmës:

- Rrethanat personale që çuan në refuzim;
- Vështirësitë në sistemin e ndihmës; dhe
- Konteksti shoqëror e personal si pengesa për ndihmën.

Secila nga këto kategori diskutohet me detaje në seksionet e mëposhtme.

Pjesa II: Rrethanat personale që çojnë në refuzimin e ndihmës

Përmbledhje: Viktimat e trafikimit vijnë nga dhe e gjejnë veten në rrethana shumë të ndryshme para, gjatë dhe pas trafikimit, që ndikojnë si në nevojën e tyre për ndihmë ashtu dhe në aftësinë e tyre për të pranuar ose refuzuar lirshëm. Faktorë si nevoja financiare, mundësitë lokale, marrëdhëniet dhe detyrimet në familje kontribuojnë dhe farkëtojnë rrethanat, ku individët e gjejnë vetveten. Disa viktima refuzojnë sepse:

- **Ndihma pengon emigrimin:** Në disa ambiente, emigrimi është strategjia mbizotëruese ekonomike dhe alternativat në vend janë jashtëzakonisht të kufizuara. Si rrjedhojë, viktimat mund të “rigjallërojnë” planin e tyre origjinal për emigrim, duke përdorur strategji të ndryshme për të emigruar në mënyrë më të sigurt. Disa shkuan jashtë për emigrim pune, disa ju kthyen prostituimit me përpjekjen për të bërë para; ndërsa të tjera emigruan për të qenë me dikë që “i shpëtoi” nga trafikimi, zakonisht një klient që pagoi trafikuesit ose e ka ndihmuar për t’u arratisur. Ndërsa në raste të tjera, viktimat refuzuan ndihmën sepse ato nuk ishin të lira nga trafikuesit e tyre ose ndihen të detyruara për të paguar borxhet.
- **Ndërveprimi me familjen:** Familjet kanë ndikim mbi vendimet për pranimin ose jo të ndihmës. Disa viktima kanë pasur familje që i kanë mbështetur dhe kanë preferuar të kthehen në shtëpi, sesa të hyjnë në një program ndihme. Në raste të tjera, ka qenë e vështirë për të pranuar ndihmën sepse familja ka qenë mosbesuese (për organizatën ose viktimën) dhe nuk e ka pranuar mungesën e saj në familja. Në disa ambiente, ka pasur gjithashtu një besim të fortë, se, kur një viktimë kishte nevojë për mbështetje, kjo duhet të jepej brenda familjes. Nëse nuk shihen si mbështetëse, familjet do të stigmatizoheshin, nëse, për shembull, një viktimë minorene do të jetonte në një institucion.

Ato nuk kanë nevojë për ndihmë: Disa viktima nuk kanë nevojë për ndihmë të veçantë trafikimi – ose ato nuk kanë ndonjë nevojë të paplotësuar, ose ato mund të marrin mbështetje nëpërmjet familjes, rrjeteve shoqërore ose mbështetje nga komuniteti jo të lidhur në veçanti më trafikimin.

4. Kur ndihma pengon emigrimin

Për shumë gra, refuzimi i ndihmës është i lidhur me një vendim (ndonjëherë i detyruar) për të shkuar jashtë përsëri. Ajo çka është kritike e duhet vënë në pah është fakti se “të shkosh jashtë”, ndonëse ndonjëherë një eufemizëm për prostitucionin, në realitet, nënkupton gjëra të ndryshme për viktime të ndryshme të trafikimit.

Emigrim për arsye pune/fuqie punëtore

Disa viktime të trafikimit mund të përpiqen përsëri të emigrojnë për të punuar. Në veçanti, kjo mund të ndodhë në vende si Shqipëria dhe Moldavia, ku emigrimi është një strategji ekonomike normative. Gjithashtu, ka shumë të ngjarë se, kur të kthehen, viktimat përballen jo vetëm me po të njëjta kushte (shpesh të mjera), që i çuan të emigrojnë, por edhe me ndikimin (personal e shoqëror) të përvojave të tyre negative jashtë.

Një grua me një përvojë tepër traumatike jashtë u shpreh se ajo do të dëshironte të shkonte prapë, por donte të sigurohej, se oferta këtë herë të ishte e sigurt:

Dikush që unë njoh shkoi në Norvegji dhe qëndroi për dy muaj por nuk kishte punë e ai u kthye. Ata shkuan për të mbledhur luleshtrydhe. Ai donte të qëndronte për tre muaj por qëndroi vetëm për dy muaj dhe nuk kishte fituar shumë... por prapë njerëzit shkojnë. Do të doja të shkoja por do të doja të isha e sigurt.

Duke synuar prostitucion të pavarur

Disa viktime e refuzojnë ndihmën për viktimat e trafikimit sepse ato kanë si qëllim të emigrojnë përsëri, të prostitutojnë në mënyrë të pavarur. Për disa gra, prostitucioni ishte pjesë e planit të tyre origjinal për të emigruar por ato përfunduan të trafikuar. Disa prostituonin para se të largoheshin nga vendi i tyre. Brenda këtij grupi, disa akoma mund të zgjedhin të ri-prostitutojnë si një mënyrë për të fituar para. Në këto raste, ndihma e posaçme pas trafikimit nuk mund të përputhet me planet e tyre ose vetë-perceptimin, pasi programet në përgjithësi kërkojnë që ato të lenë prostitucionin. Ky është një grup mjaft i cënueshëm ndaj ri-trafikimit, sepse në shumë kontekste, alternativat për emigrim të sigurt dhe prostituim të pavarur janë mjaft të kufizuara.

Kërkimi i një marrëdhënie me “shpëtuesin”

Disa gra janë ndihmuar nga klientët për t'u arratisur nga trafikuesit e tyre. Disa klientë thjesht i blenë gratë nga trafikuesit, duke i mbajtur si “gra” ose si shërbëtoresh personale; disa klientë ishin vërtetë më të interesuar për të shpëtuar këto gra. Një burrë mori në

telefon linjën telefonike të ndihmës në vendin e tij, u kaloi informacionin mbi shërbimet këtyre grave e u dha lekë dhe biletat e avionit për t'u kthyer në shtëpi.

Në disa raste gratë u larguan nga programet e ndihmës për të jetuar me këta “shpëtues”; një grua na tha se ajo mendonte shpesh që të bashkohej me burrin që e kishte ndihmuar jashtë shtetit, pasi ai e kishte trajtuar atë mirë. Në përgjithësi, ofruesit e shërbimeve shqetësohen për viktimat e trafikimit që janë kthyer në vendin ku ato janë trafikuar, me qëllim që të jenë më dikë që i ka shpëtuar – p.sh. nga frika se mos ato ri-trafikohen ose shfrytëzohen/abuzohen nga ky njeri.

Nëse gratë janë në rrezik të trafikohen në prostitucion përsëri në këto situata është e vështirë për ta vlerësuar. Megjithatë, ato shpesh do të jenë në një pozitë shumë të cënueshme – të varura nga ky njeri, pa një rrjet mbështetjeje, mbase edhe pa një status ligjor në vend etj. Por, ka edhe disa histori të suksesshme në lidhje me këta shpëtues, që shërbejnë për të inkurajuar të tjerët që të përpiqen për të njëjtën gjë.

Trafikim i vazhduar dhe ri-trafikimi

Disa gra e refuzuan ndihmën pasi trafikimi i tyre nuk kishte përfunduar edhe pse ishin kthyer në shtëpi. Kur viktimat kapen jashtë gjatë aksioneve të policisë ose kontrolleve të dokumentave dhe deportohen, ato shpesh janë ende të varura nga barra e borxhit dhe trafikuesi në përgjithësi, e di se ku janë ato.

Në situatat e borxhit, viktimat mund të jenë të detyruara të mbajnë kontakt me trafikuesit (ose të paktën të mos i largojnë ata) pasi ato nuk dinë për pasojat (për veten e tyre ose familjet) nëse ndërpresin kontaktin. Meqë, shumica e programeve kërkojnë që gratë t'i japin fund kontaktit me trafikuesit, kjo mund të frenojë aftësinë e tyre për pranuar ndihmën. Më tej, trafikuesit mund ta interpretojnë pranimin e ndihmës si të barazvlefshëm me bashkëpunimin me policinë, çka mund të çojë (ose viktimat kanë frikë së do të çojë) në ndëshkim.

Kur viktimat e trafikimit janë të varura emocionalisht nga trafikuesit e tyre (një teknikë e zakonshme e disa trafikuesve) mund të jetë tej mase e vështirë për t'u larguar. Një grua e refuzoi ndihmën e ofruar në mënyrë të përsëritur për vite me radhë ndërsa ishte e trafikuar në një vend të Evropës perëndimore. Ndërsa për një sy të jashtëm, situata e saj përbënte një shfrytëzim nga një rrjet kriminal, ajo e shihte marrëdhënien e saj me trafikuesin si një lidhje romantike. Pasi u shfrytëzua dhe u abuzua në disa vende të ndryshme, përfshirë edhe si transportuese droge, ajo akoma ndihej e detyruar të shlyente paratë që burri pretendonte të kishte harxhuar për të. Kjo nënkuptoi që ajo u kthye në vendin ku ai e shfrytëzonte, pasi kishte refuzuar, sipas të gjitha normave, një ofertë tërheqëse ndihme në një vend të tretë. Ndërsa ajo nuk kishte më lidhje me këtë burrë në kohën e intervistës, ajo kishte akoma mëdyshje për lidhjen. Nga njëra anë, ajo shprehej se nuk e kuptonte se si nuk kishte marrë më parë ndihmën; nga ana tjetër ajo e ndjente akoma se trafikuesi i saj nuk kishte faj pasi ajo e kishte lejuar. Pamundësia e saj për t'u kthyer në shtëpi për shkak të një situatë familjare shumë të trazuar shërbenin për të kufizuar më tej alternativat e saj për t'u larguar.

Lidhur ngushtë me këtë është fakti se disa viktima ri-trafikohen. Duke marrë në konsideratë situatën financiare dhe shoqërore që shumë viktima të trafikimit përballen

kur kthehen, disa nuk shikojnë ndonjë alternativë tjetër përveç se të shkojnë përsëri jashtë, madje dhe me të njëjtët organizatorë, me shpresën se do të fitonin të paktën disa para. Për më tepër, viktimat e kthyer mund të jenë shumë të dukshme në komunitetet e tyre të vogla. Trysnia e vështirësive financiare e kombinuar me stigmën (shih seksionin 11 për format e ndryshme të stigmës) krijojnë një cënueshmëri që mund të jetë edhe më e fortë sesa ka qenë, kur ato u trafikuan për herë të parë.

5. Ndërveprimi me familjen kur vendosin për ndihmën

Familja luan një rol të rëndësishëm në vendimet e viktimës për ndihmën – ndonjëherë duke ndikuar vendimin, herë të tjera duke marrë vendime efikase, veçanërisht në rastin e minoreneve. Ndikimi i familjes gjithashtu varet nga natyra e sistemit të ndihmës, sepse disa viktima mund të marrin ndihmën në komunitet e tyre lokale, edhe pse ndihma lokale mund të jetë më pak gjithëpërfshirëse.

Edhe koha mund të luajë një rol, meqenëse marrëdhëniet mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, duke ndikuar kryesisht nevojat e ndihmës dhe prirjen për të pranuar ndihmën. Shpesh viktimat kthehen në familjet e tyre menjëherë pasi kthehen, por gjejnë se disa marrëdhënie kanë ndryshuar ose se ato kanë nevojë për ndihmë nga jashtë për të zgjidhur problemet e tyre – për shembull, ndihmë psikologjike. Kjo e bën të rëndësishëm faktin se të gjitha viktimat e trafikimit duhet të kenë informacionin e nevojshëm për të kërkuar shërbimet e duhura në fazat e mëvonshme, nëse ato zgjedhin këtë gjë.

Ka disa rrethana të ndryshme në varësi të cilave viktimat zgjedhin që të kthehen në familjet e tyre sesa të regjistrohen në një program ndihme. Ajo çka mund të duket, në sipërfaqe, si një model i njëjtë – d.m.th kthimin në familje pas trafikimit – përbëhet nga një numër i madh motivimesh dhe mekanizmash.

Kthimi në shtëpi për mbështetje familjare

Për pjesën më të madhe të grave, tendenca e parë është që të kthehen tek familjet e tyre pasi kanë dalë nga trafikimi. Në veçanti, kjo është diçka e zakonshme midis grave që kanë kaluar përvoja mjaft traumatike dhe mund të ndodhë, që viktima shumë të tramautizuara (d.m.th ato që mund të përfitojnë më shumë nga ndihma) janë një grup që ka më shumë të ngjarë që të refuzojnë. Shumë prej tyre përshkruajnë vështirësi të mëdha për të besuar të huajt; shumë të tjera dëshironin vetëm të ktheheshin në shtëpi e të mos mendonin më për përvojat e tyre.

Dëshira për të shkuar në shtëpi reflekton një marrëdhënie familjare të gëzueshme e të shëndetshme; shumë viktima që pranuan ndihmën e bënë këtë gjë për shkak të marrëdhënieve jo të mira në familjen e tyre dhe pamundësisë për t'u kthyer në shtëpi. Një grua që u kthye në shtëpinë e saj pasi kishte qëndruar në fillim në strehëz u rrah nga familja e saj dhe ajo tha që ishte më mirë e vdekur. Familja e saj kishte frikë se reputacioni i tyre do të njollosej nga prostitucioni i saj. Ajo u kthye në strehëz. Studimet

mbi trafikimin tregojnë se shumë viktime të trafikimit vijnë nga ato që quhen “familje jofunksionale”. Megjithatë, studimi mbi këtë grup është zakonisht i bazuar tek viktimat që kanë marrë ndihmë dhe zakonisht tek viktimat që kanë qëndruar ose janë duke qëndruar në një strehëz. Si rrjedhojë, ka të ngjarë që të ketë një paragjykim të dukshëm në këtë grup, ndërsa viktimat me familje që funksionojnë mirë janë më shumë të prirura për t’u kthyer në shtëpi sesa të pranojnë madje dhe një mbështetje minimale.

Disa modele të ndihmës e kufizojnë kontaktin ndërmjet viktimave dhe familjes, edhe kur familja nuk ka qenë e përfshirë në trafikim. Kjo mund të nënkuptojë që viktimat refuzojnë, pasi kostoja e ndihmës është shumë e lartë kundrejt humbjes së kontaktit me familjen e tyre. Gjithashtu, mund të shkaktojë dyshim mes prindërve, për shembull, të viktimave të trafikimit në moshë të vogël, të cilat në shumicën e rasteve, kanë qenë mashtruar nga trafikuesit dhe ndoshta, arsyeshem nuk mund të pritët, që ata të besojnë një ofrues shërbimi (shpesh i panjohur) për fëmijët e tyre.

Kur familja nuk ka besim tek ndihma

Në shumë raste, familja nuk e ka idenë ose di shumë pak se çfarë i ka ndodhur viktimës, e cila shpesh nuk tregon për shfrytëzimin. Si rrjedhojë, është e vështirë për familjet të kuptojnë nëse ato kanë nevojë për ndihmë apo jo. Familja shpesh nuk ka as informacion mbi ndihmën – për çfarë është ajo saktësisht, çfarë përmban, dhe ku ndodhet strehëza – ata as nuk do të jenë në gjendje të vizitojnë ambientet. Sikurse e tha një oficer policie:

Në përgjithësi, familja nuk dëshiron që viktime të shkojë në strehëz. Kjo ndodh pasi ajo ka qenë për dy vite larg dhe tani është kthyer. Ata duan që ajo të kthehet në shtëpi, dhe ne përpiqemi t’u shpjegojmë situatën, por ata na thonë, se po u biem në qafë dhe nuk dëshirojnë ta shohin si ndihmë.

Pavarësisht arsyeve të mira për informacion të kufizuar rreth strehëzave, kuptohet se është konfuze dhe shqetësuese për anëtarët e familjes, sidomos kur viktime ka qenë larg për një kohë të gjatë dhe familja nuk e ka ditur se ku dhe çfarë ka ndodhur. Shumë viktime e përshkruan dyshimin dhe shqetësimin, veçanërisht të prindërve, se ato po abuzoheshin ose shfrytëzoheshin në strehëza. Si e tillë, nuk është e çuditshme që disa familje i dekurajojnë vazhdimisht viktimat për të pranuar ndihmën.

Kur familja nuk ka besim tek viktime

Për disa viktime, ndihma bëhej e vështirë për shkak të xhelozisë së bashkëshortit dhe dyshimit se bashkëshortja kishte një marrëdhënie të jashtëligjshme ose ishte e përfshirë në prostitucion dhe jo në një program ndihme, sikurse e shpjegoi dhe një punonjëse sociale:

Ndonjëherë na merrnin burrat në telefon që nuk e besonin se gratë ishin në [vendin ku kishim programin] dhe ata merrnin në telefon gratë disa herë në ditë për t’u siguruar se ishin aty.

Kjo ilustron gamën e vështirësive të lidhura me njëra-tjetrën, që viktimat e trafikimit përballen kur kthehen. Ndërsa familjet çlirohen se ajo është kthyer, emocione të tjera dalin në sipërfaqe, shumë nga të cilat përfshijnë mosbesimin. Kjo ndodh më shumë kur viktima mban të fshehtë se çfarë ka ndodhur me të. Një punonjëse sociale e ka shpjeguar si më poshtë:

Çfarë do të mendoja unë për fëmijën ose gruan time nëse ajo kthehet në shtëpi me shumë probleme gjinekologjike dhe nuk do të më tregojë se çfarë ka ndodhur? Ajo qan gjatë gjithë kohës ose është shumë agresive; diçka e keqe i ka ndodhur por ndoshta ajo ka bërë diçka të gabuar, u kthye e deportuar, ose pa dokumenta, nuk i përgjigjet telefonit ose largohet nga shtëpia për disa ditë dhe duhet të kujdesem për të, ajo nuk është më një njeri i mirë.

Familja duhet të kujdeset për veten e tyre

Disa vendime për refuzimin kanë qenë të lidhura me shqetësimin e familjes për reputacionin e tyre. Domethënë, ka tregues në disa ambiente, se pranimi i ndihmës në vetvete mund të jetë stigmatizuese, pavarësisht lidhjes së trafikimit për prostitucion. Në veçanti, ky është rasti për prindërit e minoreneve, të cilët duke pranuar ndihmën për fëmijët e tyre, mund të shihen si një familje e paaftë ose jo e gatshme për të ndihmuar fëmijën e tyre. Pranimi i ndihmës, që i identifikon ata si prindër të papërshtatshëm, siç është rasti i vendosjes së një anëtarit të familjes në strehëz, mund të ketë jehonë negative në komunitetin lokal, i cili, në rastin e fundit mund të kishte një ndikim negativ për viktimen e trafikimit. Pjesërisht, kjo mund të zgjidhet nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të bazuara në komunitet që mund të aksesohen, ndërsa familja akoma ofron kuadrin e përgjithshëm të kujdesit dhe mbështetjes, në përputhje me sistemin e tyre të vlerave për kujdesin ndaj fëmijëve të tyre.

6. Viktimat që nuk kanë nevojë për ndihmë

Në disa raste, ndihma formale nuk kërkohet ose nuk dëshirohet nga viktimat e trafikimit, në kundërshtim me hamendësimin e përgjithshëm, se viktimat e trafikimit kërkojnë (dhe dëshirojnë) ndonjë lloj ndihme apo mbështetje për të rigjetur veten dhe për t'u ri-integruar në shoqëri.

Viktima që nuk kanë nevojë të papërbushura

Disa viktima nuk kanë nevojë për ndihmë, sepse ato mund t'ia dalin mbanë vetë. Pasi i kanë mbijetuar dhe shpëtuar trafikimit, disa viktima ndihen të pajisura për të menaxhuar kthimin dhe/ose ri-integrimin në shoqëri. Disa kanë pranuar ndërhyrje emergjente – p.sh. strehim i përkohshëm ose shërbime mjekësore – por jo ndihmë të mëtejshme. Ndërsa të tjera e kanë marrë veten pa ndonjë ndërhyrje apo ndihmë. Një grua që kishte

qenë jashtë për një kohë të shkurtër refuzoi të gjitha format e ndihmës kur u kthye, madje ndryshoi dhe numrin e telefonit për të shmangur kontaktimin nga ofruesit e shërbimeve. Ndërsa një faktor ishte mbajtja e përvojës së saj sekret nga i shoqi, ajo vazhonte të refuzonte sepse studionte dhe kishte mbështetjen e nënës së saj, sikurse dhe e shpjegoi:

Kur takova disa gra tek strehëza [jashtë shtetit], pashë që ata kishin nevojë për ndihmën e ofruar për studimet dhe punën e tyre. Kurse unë studioj dhe e kam një punë. Për çfarë ndihme kam nevojë? Gratë që takova kishin nevojë për ndihmë sepse ato shkuan jashtë për të gjetur një punë sepse për ato nuk kishte rrugë tjetër

Edhe në situatat, ku viktimat kanë më pak alternativa në shtëpi, shumë prej tyre nuk kërkojnë ndihmë sepse ato nuk i perceptojnë nevojat e tyre në të njëjtën mënyrë sikurse e bën një vëzhgues i jashtëm. Një grua kishte qenë në shtëpi për tetë muaj para se ajo të kërkonte ndihmë, pavarësisht nga skamja që ajo dhe fëmijët e saj përballeshin. Ajo fitonte bukën e gojës duke shitur arra; vetëm kur i mbaruan arrat, ajo kërkoi ndihmë. Në të njëjtën mënyrë, një grua, e rekomanduar nga mjeku i saj për tek strehëza, ju ofrua një shumëllojshmëri alternativash ndihme, por pasi bisedoi me asistentët social, i refuzoi ato. Sikurse ajo shpjegonte, nevojat e saj për ndihmë ishin kryesisht mjekësore dhe ajo ishte e kënaqur me këtë shërbim. Një viktimë tjetër shpjegoi se, për atë, ndihma më e rëndësishme ishte periudha e pushimit dhe reflektimit në strehëz dhe nuk kishte nevojë për më tepër.

Nëse dikush ka nevojë për ndihmë, gjithsesi, ndryshon me kalimin e kohës dhe viktimat mund të përballen me një krizë që shkakton nevojën për ndihmë. Një viktimë refuzonte të gjithë ndihmën derisa ajo u kërcënua nga policia që e detyronte atë të dëshmonte kundër trafikuesit të saj. Vetëm atëherë e kërkoi ajo agjencinë që i kishte ofruar asistencën fillimisht. Pa këtë shkak, ajo mund të mos kishte pranuar. Sikurse tha, ajo do të kishte gjetur mënyrën për t'ia dalë mbanë vetëm, si kishte bërë në të kaluarën.

Për t'u theksuar është fakti se, disa organizata nuk mund të pranojnë lehtësisht se disa viktima mund të mos kenë nevojë për ndihmë. Një grua mori pothuajse për një vit ndihmë të orientuar drejt ri-integrimit në vendin e destinacionit dhe po kthehej në një familje që e mbështeste. Ndërsa ofruesit e shërbimeve në vendin e destinacionit vlerësuan se ajo duhej të kthehej direkt tek familja e saj, ofruesit e shërbimeve partnerë në vendin e saj ngulën këmbë, se ajo duhet të qëndronte fillimisht në një strehëz në kryeqytet.

Viktimat me burime të tjera mbështetjeje

Disa viktima e refuzojnë ndihmën formale sepse ato kanë akses ndaj formave alternative të mbështetjes:

Mbështetje e bazuar në familje

Alternativa më e zakonshme ishte kthimi në familje për ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme. Një viktimë e refuzoi ndihmën sepse nëna e saj këmbëngulte, që ajo të

kthehej në shtëpi edhe pse ishte shtatzënë, shpesh një burim tensioni dhe madje refuzimi të viktimave të trafikimit. Sikurse shpjegonte e ëma e saj:

Ne mezi prisnim që ta shihnim atë, kur ajo u kthye. Ne ishim aq të shqetësuar. Ne ishim aq të emocionuar që ajo u kthye sa e pranuar fëmijën ... Ka vend mbrapa dhe mbase do të hapim dhe vend për fëmijën për të fjetur.

Personeli i strehëzës pohoi se ishin ato pa familje ose pa mbështetjen e familjes që në mënyrë tipike e pranojnë ndihmën: “Pres që të ketë shumë raste të viktimave të trafikimit të suksesshme, familjet e të cilave i pranojnë dhe ato të marrin ndihmë por jo nga ofruesit e shërbimeve të trafikimit.”

Ndërsa disa gra mendojnë se ato do të gjejnë mbështetje në familjet e tyre, në realitet kthimi në familje nuk përkthehet gjithnjë në ndihmë të vërtetë, as edhe nuk përkthehet në një ambient të sigurt dhe mbrojtës. Sikurse dhe një nga personeli vëren, “Një viktimë mund të mbahet brenda shtëpisë ose ambientit të shtëpisë për një kohë të gjatë, pa qenë e aftë të dalë. Kjo është familja që e “mbron” atë por nuk është mbrojtje e vërtetë”. Ofruesit e shërbimeve kanë raportuar shumë raste kur “refuzueset” ishin kthyer për ndihmë pasi nuk kishin gjetur mbështetjen e mjaftueshme brenda rrjetit familjar. Në disa raste, familjet e kuptuan që nuk ishin në gjendje të ofronin mbështetjen e nevojshme dhe kontaktuan me programin e asistencës për ndihmë – për shembull, kur viktimat kishin nevojë për ndihmë materiale dhe ekonomike, mbështetje shoqërore dhe psikologjike, mbrojtje për shkak të problemeve të sigurisë ose kur viktimat po përballej me vështirësi ose stigmën në familje/komunitet.

Kur kthehen në familje, disa viktimat u shpjegojnë (disa ose të gjithë) anëtarëve të familjes se çfarë u ka ndodhur dhe marrin mbështetje. Të tjera nuk e bëjnë këtë. Një psikolog shpjegoi se këto gra shpesh nuk u tregojnë familjeve për të mbrojtur jo vetëm vetveten por edhe familjen e tyre:

Ajo çka ndodh është se vetëm disa vajza u rrëfejnë familjeve të tyre se ato kanë qenë trafikuar. Dy arsye: një pjesë e tyre janë të frikësuar që familja nuk do t'i falë dhe t'i pranojë, dhe pjesa tjetër e vajzave kanë marrëdhënie të mira me familjen dhe ato nuk duan të lëndojnë ndonjë ose nuk duan të prishin marrëdhënien e tyre, duan ta mbajnë barrën vetë. Vetëm disa vajza u tregojnë ose nënave ose motrave të tyre.

Mbështetje nga rrjeti shoqëror

Disa nga viktimat e kthyerat e gjejnë mbështetjen për të cilën kanë nevojë në rrjetin e tyre shoqëror. Kjo mund të jetë si për ndihmën e përkohshme ashtu edhe për atë afat-gjatë dhe marrëdhëniet nuk kanë qenë gjithmonë të ngushta. Gratë e trafikuarat ishin të përgatitura për të marrë parasysh mundësi dhe konstelacione të ndryshme shoqërore – miq, kolegë, fqinj dhe të njohur. Një grua shpjegoi se si ajo kishte marrë në konsideratë një gamë alternativash para pranimit të ndihmës, midis tyre të qëndronte me një të njohur në kryeqytet, sesa të kthehej në shtëpi.

Ka edhe raste më të ndërlikuar ku viktimat mbështeteshin tek të “dashurit”/”bashkëshortët” që i kishin takuar gjatë trafikimit. Në disa raste, këto janë marrëdhënie “të vërteta”, të shëndetshme dhe afat-gjate. Në raste të tjera, marrëdhënia

mund të jetë një hile për ta ri-trafikuar atë. Ajo mund të jetojë gjithashtu me një klient ose punëdhënë të mëparshëm, duke i ofruar shërbime seksuale dhe shtëpiake, situatë e afërt me trafikimin. Kjo mund të shpjegojë refuzimin e pjesës më të madhe ose të të gjithë ndihmës nga viktimat.

Mbështetje e bazuar në komunitet

Disa komunitete kanë mekanizma jo formalë të ndihmës për viktimat e trafikimit (si dhe grupe të tjera shoqërore të cënueshme). Refuzimi i ndihmës mund të jetë më pak i dukshëm në ndihmën e bazuar në komunitet, pasi viktimat mund të kthehen tek familjet e tyre dhe mund të marrin forma të ndryshme të ndihmës, si gjetja e një vendi pune ose arsim formim profesional.

Në disa komunitete, organizatat fetare luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e ndihmës shoqërore. Kjo mund të jetë me vlerë në adresimin e ndonjë rezistence të mundshme apo dyshimi ndaj ndihmës nga organizata “të jashtme”. Gjithsesi, disa ndihma fetare mund të jenë të kushtëzuara nga angazhimet fetare ose të lidhura me pozicionin ideologjik të organizatës (p.sh. mbi abortin, prostitucionin dhe/ose martesën) që mund të ketë një ndikim negativ ose të kufizuar mbi alternativat e ndihmës.

Ndihmë që nuk lidhet me trafikimin

Gjithashtu, ka pasur raste kur viktimat janë ndihmuar nga jashtë kornizës së trafikimit në rajonin e vendit të tyre. Veçanërisht, kjo ndodh në rastin e atyre që janë jashtë kryeqyteteve dhe qyteteve të mëdha, ku ofruesit e shërbimeve kundër-trafikimit nuk janë të pranishëm ose më pak të njohur. Në disa raste viktimat mund të zgjedhin ndihmë që nuk lidhet me trafikimin; të tjera mund të kenë vetëm këtë alternativë. Një vajzë e rrëmbyer u identifikua si viktimë e trafikimit vetëm gjatë procedurave gjyqësore. Para kësaj, ajo mori mbështetje dhe ndihmë psikologjike si pjesë e kuadrit të ndihmës shoqërore. Ajo dhe nëna e saj – që e mbështeste – e refuzuan ndihmën e mëtejshëm (të posaçme pas trafikimit) sepse ato kishin marrë tashmë ndihmë emergjente dhe thanë, më tej, se ato mund t’ia dilnin mbanë vetë. Për këtë vajzë, mbështetja e familjes dhe shërbimet e emergjencës (por jo të posaçme pas trafikimit) ishin qendrore në rikuperimin e saj.

Pjesa III: Vështirësitë në sistemin e ndihmës

Përmbledhje: Disa vendime për refuzimin e ndihmës janë të lidhura drejtpërdrejt me mënyrën se si sistemi i ndihmës është i rregulluar. Jo të gjitha programet ishin të pranueshme dhe/ose të aksesueshme për personat e trafikuar. Arsyet për këtë, në përgjithësi, mund të ndahen si më poshtë:

- **Probleme të informacionit dhe komunikimit.** Disa viktima nuk kanë qenë në gjendje të marrin një vendim për ndihmën për shkak të dhënies së pamjaftueshme të informacionit. Informacioni mbi ndihmën ishte shpesh i përgjithshëm dhe konfuz. Strategjitë e suksesshme përfshinin kur viktimave u janë treguar ambientet për ndihmë dhe viktimat e tjera kanë përshkruar se çfarë kanë marrë. Ndonjëherë, ofrimi i informacionit ishte bërë i vështirë nga paaftësia e viktimit për të përpunuar dhe kuptuar informacionin. Kjo lidhet me gjendjen mendore të viktimit kur e merr informacionin, si dhe me nivelet e përgjithshme të kuptimit dhe përvojat e mëparshme me ndihmën. Në shumë raste, ka pasur një dhënie të pamjaftueshme të informacionit në gjuhën amtare të viktimit ose në një gjuhë që ajo mund të kuptonte.
- **Organizimi i ndihmës.** Për disa viktima, mënyra se si ndihma është e organizuar ndikon mbi aftësinë e tyre për ta pranuar atë. Në shumë raste, nevojat e posaçme të viktimave nuk ishin adresuar siç duhej – p.sh. viktimat me aftësi mendore të kufizuara, familjet me nevoja për ndihmë. Në rastet e tjera, pranimi i ndihmës nënkupton që të mos jesh i aftë të fitosh të ardhura, të cilat shumë viktima nuk mund t'i përballojnë, veçanërisht kur kanë vartës. Disa viktima kanë frikë se mos trafikohen përsëri sepse ofertat e ndihmës dhe një jetë më e mirë, është e njëjta gjë që bëhej nga trafikuesit. Në disa raste, viktimat e refuzuan ndihmën sepse ndjenin se ato dhe familjet e tyre nuk do të ishin të mbrojtura mjaftueshëm ndaj trafikuesve.
- **Ndërveprimet ndërmjet ofruesve të shërbimit dhe viktimave:** Në disa raste, programet u konsideruan si shumë të kufizuara nga personat e trafikuar. Ky ishte rasti, në veçanti, i strehëzave të mbyllura që kufizonin kontaktin me botën jashtë.

7. Probleme të informacionit dhe komunikimit

Mos të kuptuarit e shërbimeve që ofrohen, nga kush dhe si, ishte një arsye relativisht e përgjithshme për të refuzuar ndihmën. Madje dhe viktimat që kishin pranuar ndihmën përshkruanin nivele të larta konfuzioni kur atyre ju ofruan për herë të parë shërbimet. Kur u pyetën se çfarë prisnin ato nga një strehëz, gratë e trafikuarat kishin përgjigje të ndryshme: “shtëpi plot me njerëz, fëmijë dhe gra dhe gjithashtu plot me kamera”; “bodrum me hekura”, “një mashtrim” ose “një shtëpi plot me njerëz”. Të tjerat nuk ishin të sigurt nëse mund t’u besonin ofruesve të shërbimit ose policisë dhe madje të shqetësuara se mos trafikoheshin përsëri.

Informacion i pamjaftueshëm ose konfuz për ndihmën

Shpesh viktimat nuk e kuptonin plotësisht çfarë ndihme u ofrohej, veçanërisht në fillim, kur ato identifikoheshin. Një viktimë, e identifikuar jashtë shtetit nga zbatuesit e ligjit dhe e ndihmuar atje nga shërbimet shoqërore qeveritare, nuk iu tregua për ndihmën në vendin e saj, dhe as që duhej të kontaktonte me policinë. Ajo tha se ishte një “shok i madh dhe traumë” dhe mendonte se punonjësit socialë jashtë duhet t’i shpjegonin më shumë se çfarë do t’i ndodhte kur të arrinte. Kjo ishte tipike – në përgjithësi viktimave u thuhej me gojë në vija të përgjithshme për ndihmën dhe u jepnin detaje kontakti për të vazhduar më tej, nëse ato zgjidhnin këtë gjë por kishte shumë pak informacion të veçantë (ose me shkrim) se çfarë përmbanin shërbimet ose organizatat e ndihmës.

Viktimave, të paktën, duhet t’u jepej ndonjë material me shkrim i përshtatshëm për moshën, gjuhën dhe nivelin e arsimit të përfituesve dhe të ishte i disponueshëm për referencë në të ardhmen, veçanërisht sepse shumë viktima kërkojnë më shumë kohë të kuptojnë dhe të marrin një vendim në lidhje me ndihmën. Disa organizata i ftojnë viktimat të vizitojnë ambientet dhe të takohen me përfitueset e tjera. Vetëm kur ju kërkohet që të vendosin dhe, nëse ato refuzojnë, përsëri u japin alternativën që të kthehen më vonë. Një psikologe u shpreh: “Është tjetër gjë t’u thuash për ndihmën dhe tjetër gjë t’ua tregosh”.

Ndarja e informacionit duhet të marrë parasysh realitetin e proceseve të identifikimit dhe referimit. Disa viktima nuk janë të hapura, ose madje edhe armiqësore ndaj idesë së ndihmës. Më tej, kushtet për shkëmbimin e informacionit shpesh nuk janë dhe ideale duke pasur parasysh një sërë situatash (të komplikuar) – p.sh. sapo mbërrijnë në aeroport (ndonjëherë me anëtarë të familjes të pranishëm), me praninë e zbatuesve të ligjit ose gjatë transportimit për në shtëpi.

Nuk është e qartë nëse informacioni për ndihmën që i drejtohet publikut të gjerë i arrin viktimat e trafikimit. Një viktimë që kishte qenë në shtëpi për shumë vite nuk kishte parë asnjë informacion në lidhje me alternativat e ndihmës, edhe pse ishin zhvilluar disa fushata në atë periudhë. Ajo e kuptoi se mund të gëzonte të drejtën e ndihmës vetëm kur foli me një të njohur në një bar, një mbrëmje. Po aq e rëndësishme është se kush e shpërndan informacionin, si ndërmjetësues të mundshëm janë punonjësit në terren, stafi mjekësor, zbatuesit e ligjit, personeli i industrisë së turizmit, personeli i transportit, personeli i ambasadës e kështu me radhë. Personat e trafikuar

duhet të përfshihen për të përcaktuar, se çfarë dhe si informacioni mund të paraqitet më mirë dhe të ndahet me personat e trafikuar.

Disa viktimave ju ofruan oferta ndihme nga organizata të ndryshme (konkurrente), gjë që ju duk konfuze dhe e sikletshme. Gjithashtu, kjo mund të bëjë që përfitueset e pakënaqura dhe të mërzitura t'i vënë ofruesit e shërbimit në konflikt me njëri-tjetrin për të marrë më shumë shërbime të ndryshme. Bashkëveprimi midis agjencive mund të sigurojë se shërbimet janë të përshtatshme dhe që zbatohen me efikasitet dhe/ose në mënyrë të drejtë.

Ka gjithashtu një mungesë të informacionit të qartë për shërbimet ndërmjet ofruesve të shërbimit. Një sërë ofruesish shërbimesh në vendet e destinacionit e ndjenin se ata nuk kishin informacion të mjaftueshëm për shërbimet në vendin e origjinës. Në të njëjtën mënyrë, ofruesit e shërbimeve në vendet e origjinës e ndjenin se me përpjekjen për të krijuar stabilitet dhe ri-siguri, homologët në vendet e destinacionit shpesh e tepronin me shërbimet dhe ndihmën e premtuar.

Mungesa e kapacitetit për të kuptuar se çfarë ofrohet

Në disa raste, aftësia për t'i kuptuar shërbimet që ofrohen lidhet me kapacitetet specifike të viktimave – p.sh. gjendjen e tyre psikologjike, kapacitetin e të kuptuarit, gjuhën dhe përvojën me ndihmën.

Gjendja psikologjike e viktimave

Shumë viktima hyjnë në kontakt me personelin kundër-trafikimit shpejt pas daljes nga trafikimi, kur ato janë në shok ose madje dhe të traumatizuara. Si rezultat, ato nuk janë gjithnjë në gjendje të kuptojnë së çfarë po ndodh përfshirë shërbimet e ofruara. Sikurse dhe një ofrues shërbimesh shpjegoi: “Ato janë të frikësuara, të lodhura, të rraskapitura dhe të uritura e nuk e dinë se çfarë duan. Nuk kanë asnjë ide se çfarë mund të marrin dhe ne i informojmë, por ato nuk e kuptojnë. Është një periudhë kur ajo ka nevojë për pushim për të marrë veten nga trauma”.

Një grua përshkruante se ishte në gjendje të kuptonte, se organizata që ofronte ndihmën po përpiqej ta ndihmonte atë, por në të njëjtën kohë, nuk ishte në gjendje të përpunonte plotësisht ose të bënte lidhjen me atë që po ndodhte: “E kuptova se ky person erdhi me qëllime të mira, por nga ana tjetër nuk mund ta përpuñoja informacionin shumë mirë. Nuk isha në gjendje të shihja se çfarë po ndodhte”. Anëtarët e familjes mund të përjetojnë gjithashtu shok dhe konfuzion si rezultat i trafikimit, që ndikon aftësinë e tyre për të marrë vendime. Ky shok dhe traumë në përgjithësi zvogëlohet me kalimin e kohës, duke lënë edhe mundësinë për ta ndjekur në një fazë më të vonët.

Të kuptuarit e kufizuar

Një pjesë e konfuzionit me sa duket lidhet me kapacitetin e përfitueses për të kuptuar shërbimet, kjo mund të lidhet pjesërisht me formimin e tyre, aftësitë analitike dhe vendim-marrëse dhe/ose nivelin e arsimimit. Të kuptuarit e kufizuar brenda familjes (dhe e prindërve në veçanti) mund të luajë një rol në mos-kuptimin dhe, si rrjedhojë, në

mos pranimin e ndihmës së ofruar. Kjo mund të ndodhë si në fazën fillestare ashtu dhe në fazat e mëvonshme dhe mund të na japë informacion nëse/si viktimat (dhe familjet) pranojnë shërbimet.

Mungesa e njohurive dhe përvojës me ndihmën

Një pjesë e konfuzionit ka të ngjarë të lidhet, të paktën pjesërisht, me mungesën e përvojës me ndihmën, duke e bërë të vështirë të kuptosh (dhe të besosh) se çfarë po ofrohet. Shumë persona të trafikuar shprehën surprizë (dhe si rrjedhojë, dyshim) që këto shërbime dhe programe ndihmash ekzistojnë, pjesa më e madhe kurrë nuk kanë marrë ndonjëherë ndihmë në të kaluarën, as nga OJQ-të as nga aktorët qeveritarë. Aq i rrënjosur është ky dyshim në disa raste, sa një viktimitë së cilës ju ofrua kujdesi në strehëz, zgjodhi burgun sepse me burgun ajo e dinte se çfarë e priste – ligjërisht ata mund ta mbanin vetëm për një muaj por strehëza ishte një subjekt i panjohur, një “hap besimi”. Kur familjet janë të panjohura me ndihmën, mund të jetë gjithashtu një faktor për refuzim. Në disa raste, ofruesit e ndihmës kuptuan se, nëse përfitueseve të mëparshme u kërkohej të takonin viktimat e t’u tregonin se për çfarë është ndihma, kjo gjë ndihmonte.

Pengesat e gjuhës

Një pjesë e mungesës së të kuptuarit është e lidhur me gjuhën; personeli në vendet e destinacionit nuk fliste gjuhën e viktimave. Një vajzë minorene u informua për të gjitha shërbimet në vendin e destinacionit në gjuhën lokale (të cilën ajo nuk e fliste) dhe terapia ju dha nëpërmjet përkthimit, duke ngritur pyetje në lidhje me cilësinë e përkujdesjes së marrë.

Edhe pse përkthimi nuk i kalon në mënyrë të mjaftueshme pengesat e gjuhës, gjithsesi mbetet një masë e rëndësishme. Dhe shumë programe, veçanërisht ato të OJQ-ve dhe Organizatave Ndërkombëtare marrin përkthyes nëse jua lejon buxheti. Meqë e përmendëm, përkthimi nuk është gjithnjë (ose madje gjerësisht) i disponueshëm. Mungesa e përkthimit është në veçanti e mprehtë midis agjencive qeveritare, që shpesh nuk kanë burimet për të kontraktuar përkthyes për çdo intervistë me viktimat e huaj. Kjo mund të çojë në keq-komunikim serioz, i cili, nga ana tjetër, mund të çojë në çështje të tjera, si për shembull keq-identifikimin dhe viktimat që refuzojnë ndihmën. Në lidhje me ofrimin e shërbimit, pengesat e gjuhës janë raste të izoluara për gratë, të cilat mund të shpjegojnë pakënaqësinë me shërbimet dhe madje daljen nga një program.

Çështjet e gjuhës mund të çojnë gjithashtu në keqkuptime që vënë në rrezik ndihmën e ofruar, të cilat, nga njëra anë, mund të shpjegojnë se disa viktimat kthehen në shtëpi me pritshmëri jo realiste për ndihmën dhe, nga ana tjetër, shpjegojnë refuzimin e ndihmës nga viktimat me t’u kthyer në shtëpi.

8. Organizimi i ndihmës si një arsye për të refuzuar

Meqenëse të intervistuarat ndryshonin nga mosha, gjendja ekonomike, formimi arsimor, marrëdhëniet familjare, përvojat e trafikimit etj, nuk është e vështirë të shohësh se jo i njëjti numër i përshtatet të gjitha masave përsa i përket ndihmës. Shumë viktime të trafikimit e refuzojnë ndihmën sepse ato ose nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshme për të pranuar ndihmën në formën që u ofrohet. Ndonjëherë, kjo ndodh sepse nevojat specifike të viktimës për ndihmë nuk adresohen nga programi. Herë të tjera, kjo mund të lidhet me mënyrën se si organizohet dhe ofrohet – në mënyrë tipike, programet me bazë në strehëz, në kryeqytete, me kontakt të kufizuar me familjen e që kërkojnë kohë dhe angazhimi, gjë që viktimat nuk mund ta përballojnë. Në disa raste, kushtet e ndihmës mund të mos jenë të kënaqshme, përfshirë krahasimin, në një farë mënyre, me përvojën e tyre të trafikimit dhe pa marrë parasysh mjaftueshëm frikën e tyre nga trafikuesit.

Shërbimet nuk i përshtaten nevojave ose gjendjeve të viktimave

Disa viktime të trafikimit kanë refuzuar ndihmën sepse shërbimet nuk ishin të përshtatura mirë sipas nevojave të tyre – p.sh. sepse nevojat e tyre specifike të ndihmës (nevojat personale ose të familjes) nuk adresohen nga programi ose për shkak të mënyrës se si ndihma është e organizuar ose e ofruar.

Nevoja specifike të përkujdesjes që mund të mos adresohen

Nevojat e viktimës për ndihmë janë të shumëllojshme. Përvojat e trafikimit ndryshojnë shumë dhe personat e trafikuar kanë pikënisje të ndryshme për sa u përket burimeve financiare dhe shoqërore. Të merresh me këtë shumëllojshmëri nën të njëjtin kuadër programatik me burime të kufizuara është sfiduese.

Disa nevoja individuale dhe rrethana janë në veçanti të vështira për t'u drejtuar. Për shembull, viktimat me aftësi mendore të kufizuara përbëjnë një sfidë të veçantë, pasi alternativat e trajnimit dhe të punësimit janë të kufizuara. Të ndihmosh njerëzit me sëmundje të rënda mendore brenda të njëjtit sistem sikurse dhe viktimat e tjera mund të jetë tejet e mundimshme. Viktimat që luftojnë me vartësinë ndaj drogës dhe alkoolit shpesh nuk janë në gjendje të kenë akses ndaj ambienteve të përshtatshme të trajtimit. Viktimat, që vijnë nga grupet e stigmatizuara ose të marginalizuara (si grupet e minoritetit etnik) shpesh kanë një gamë të kufizuar alternativash.

Familja ka nevoja për ndihmë

Shumë të intervistuarat kanë kërkuar punë jashtë me qëllim që të siguronin veten e familjet e tyre dhe gjendja e tyre financiare, shpeshherë është përkeqësuar si pasojë e borxheve apo huave që kanë marrë për të financuar emigrimin e tyre. Alternativat shumë të kufizuara për të fituar para ndërsa janë duke marrë ndihmë (veçanërisht në programet e strehëzës) janë një faktor për të vendosur nëse të pranojnë ndihmën apo jo. Shumë gra, në veçanti ato në gjendje të vështira financiare kanë zgjedhur të kthehen në

shtëpi e të ndihmojnë familjet e tyre sa më shumë që të jetë e mundur, sesa të pranonin ndihmën.

Zgjedhja për të sjellë fëmijët në strehëza shihet si një faktor i rëndësishëm për të pranuar ndihmën. Disa nëna u shprehën se ato kurrë nuk do ta kishin marrë parasysh pranimin e ndihmës nëse nuk do të mund të sillnin fëmijët e tyre. Gjithsesi, një gjë tjetër për t'u marrë parasysh është dhe ambienti i strehëzës, veçanërisht për një afat kohe të gjatë dhe në këndvështrimin se si kjo do të ndikojë në mundësitë arsimore dhe zhvillimin fizik e psikologjik. Strehëzat e mbyllura (me pak ose aspak liri lëvizje) shton një nivel tjetër të stresit sikurse dhe qëndrimi me përfituese të tjera (shpesh të traumatizuara).

Ndihma është një luks që ato nuk mund ta përballojnë

Programet e ndihmës shpesh i përqendrojnë shërbimet në formën e një strehëze ose qendre ditore. Megjithatë, jo çdokush është i aftë të ketë akses ndaj këtyre formave të ndihmës sepse ato kanë detyrime të tjera, si për shembull punën. Një grua, që kishte përfituar nga mbështetja që kishte marrë, shpjegoi se nuk mund të përballonte një ndihmë të vazhdueshme:

Ishte diçka e mirë që ata erdhën e më ofruan ndihmë; më ka ndihmuar shumë, për nga ana psikologjike. Ndihesha më e qetë kur erdha këtu. Jashtë, çdo gjë ishte e errët, njerëzit thonin gjëra të këqija për mua. Por pas pak kohe nuk erdha më këtu se m'u desh të punoja.

Mundësi të pamjaftueshme sigurimi të shërbimeve lokale

Pjesa më e madhe e ndihmës kundër-trafikimit është e përqendruar në kryeqytete dhe qytete të mëdha. Meqë transporti publik është i kufizuar dhe njerëzit me mjete të kufizuara financiare shpesh udhëtojnë në këmbë, një organizatë madje në qytetin më të afërt mund të jetë e vështirë për t'u arritur. Një grua ishte në një gjendje të dëshpëruar – dukshëm, ajo kishte nevojë për ndihmë psikologjike, kishte dy fëmijë të vegjël për të mbajtur dhe po përballej me mundësinë e dëbimit. Ajo jetonte në një fshat të vogël pa transport dhe pa një rrjet shoqëror që ta ndihmonte, dhe mbështetej tek ndihma humanitare dhe tek pakot ushqimore që i dërgoheshin rrallë nga një agjenci shërbimi.

Kur asistenca barazohet me përvojat e trafikimit

Në mënyrë tipike, viktimat e trafikuar për shfrytëzim seksual kanë qenë mashtruar ose gënjyer nga dikush që i besonin, me premtime false për ndihmë dhe mbështetje për të ndërtuar një jetë të re në një vend të ri. Ofertat e ndihmës shpesh, në disa aspekte, mund t'i ngjajnë këtij procesi pasi bëhen premtime të njëjta. Kur asistenca duket sikur imiton trafikimin, mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të besuar shërbimet dhe organizatat. Një sërë viktimash kanë pasur frikë se “ndihma” mund t'i çojë në ri-trafikim. Komshia e motrës i kishte treguar një gruaje për ndihmën, por ajo ishte e frikësuar se mos ishte një kurth tjetër. Ju deshën disa muaj derisa ajo më në fund kontaktoi me organizatën, madje dhe mbasi kishte marrë pak ndihmë, ajo nuk kishte plotësisht besim:

Kisha frikë, por vendosa të shkojë e të shohë se çfarë ndërtese ishte... Atje ishte [punonjësja sociale] dhe bisedova me të dhe u shokova kur pashë një pako të madhe me ushqime, kurrë nuk kisha parë një gjë të tillë më parë. Kur ajo ma dha, u frikësova por prapë e mora, sepse nuk kisha asgjë në shtëpi. Pasi folëm pak, ajo më tha se për dy ditë mund të shkoja në strehëz, nuk e besova por mendova se diçka nuk shkonte. Ideja ime ishte të merrja pakon me ushqime por jo të kthehesha, sepse mund të më çonin në Turqi përsëri.

Për disa viktime, kufizimet e programit (p.sh të mos kesh akses ndaj celularit, të mos lejohesh të largohesh nga strehëza) u përjetuan si të zhvendosesh nga kontrolli i trafikuesit tek kontrolli i ofruesve të shërbimit në atë mënyrë sa që shërbimet nuk u kuptuan gjithnjë si “ndihmë” ose madje si përmirësim nga ana e viktimës. Kjo ndjenjë e déjà vu-së (diçkaje që e ke përjetuar më parë), mund të jetë veçanërisht rasti i strehëzave të mbyllura, ku kufizimet janë edhe më të mëdha.

Frikë nga trafikuesi

Viktimat ishin shpesh të frikësuara për të pranuar ndihmën, sepse kishin frikë se mos shihej nga trafikuesit si bashkëpunim me autoritetet dhe kjo do të çonte në raprezalje kundër tyre ose familjeve të tyre. Nëse kjo frikë është e mbështetur në kërcënime konkrete ose jo, nuk ka shumë lidhje me këtë studim. Madje dhe viktimat që nuk kishin përjetuar kërcënime të drejtpërdrejta mund të ndikohen shumë nga kjo lloj frike.

Shumë viktime dhe familjet e tyre përballen me rreziqe të sigurisë, siç është e ilustruar në rastin e “Marias” që u shpërngul në një apartament në një qytet afër por familja e së cilës qëndroi në fermë. Kur Maria dëshmoi, familja e saj u kërcënua. Policia ofroi një roje për familjen e saj dhe procedurat e gjyqësore u përshpejtuan. Megjithatë, fqinjët u kërcënuan dhe nënës së saj ju desh që të fshihej në papafingo në një rast kur trafikuesit erdhën në fshat.

Frika ndaj trafikuesve është e lidhur, të paktën pjesërisht, me korrupsionin brenda aparatit të shtetit, çka ndikon në hetim dhe ndjekjen penale të çështjeve të trafikimit. Shumë viktime kanë frikë se ato nuk do të mbrohen nga autoritetet ligjore dhe administrative të korruptuara. Trafikuesit i shfrytëzojnë këto frika shpesh duke u thënë viktimave se ata bashkëpunojnë me autoritetet. Viktima nga vendet ku korrupsioni është i mprehtë ka më shumë të ngjarë që të jenë veçanërisht të frikësuara.

Ndërsa rreziku i ndëshkimit është real në shumë raste, zbatuesit e ligjit dhe gjyqësorët, disa herë, e përdorin frikën për t’u bërë presion grave që të pranojnë ndihmën. Për zbatuesit e ligjit, është shpesh e preferueshme që viktimat të pranojnë ndihmën, pasi kjo u siguron kontakt më të rregullt e më të aksesueshëm, çka e bën hetimin e çështjes më efikas. Kjo mund të shërbejë në interes të ligjit dhe autoriteteve gjyqësore, por mbase jo gjithmonë në interes të viktimës. Një ndjenjë e përgjithshme frike dhe rreziku mund të ndikojë negativisht në ri-marrjen e vetes për personat e trafikuar. Po aq shqetësuese duhet të jenë dhe rreziqet e vërteta që nuk parashikohen siç duhet për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme.

9. Ofruesit e shërbimit dhe viktimat – kush refuzon kë?

Meqenëse ky studim përqendrohet tek viktimat e trafikimit që e refuzojnë ndihmën sesa tek ato të cilave nuk u është dhënë ndihmë, kufiri midis tyre ndonjëherë ka qenë i turbullt. Atëherë, një çështje kyçe në arsyet për pranimin ose refuzimin e ndihmës, janë dhe ndërveprimet ndërmjet ofruesve të shërbimit dhe përfituesve. Gjendja është më e ndërlikuar sesa thjesht një palë që refuzon tjetrën; tensioni dhe ndërveprimi ndërmjet ofruesve të shërbimit dhe përfituesve kërkon një shqyrtim më të kujdesshëm.

Sjellje që çon në përjashtim nga programi

Thyerja e rregullave dhe si rrjedhojë përjashtimi nga programet u shpjeguan nga disa ofrues të shërbimeve si një formë e refuzimit të ndihmës; vendimi për të thyer rregullat ishte parë si një përpjekje e ndërgjegjshme e përfituesve për t'u përjashtuar nga programi. Pyetja qëndron: a mund të interpretohet kjo sjellje ndryshe dhe a po përpiqen në të vërtetë përfitueset, që nuk respektojnë rregullat, të dëbohen?

Ndërsa në disa raste, përjashtimi nga një program u duk në fakt si një mënyrë e refuzimit të ndihmës, në disa raste, nuk ishte e qartë, sikurse e shpjegoi dhe një psikolog që punonte me fëmijët e rrugëve në rrezik trafikimi:

[Ata] shtyjnë kufijtë. Mbase është një mënyrë që të testojnë, që të thonë: “Do të më pranosh nëse unë bëj këtë gjë? Apo atë? Mund të më ndihmosh me të vërtetë? A do me të vërtetë?”

Është e kuptueshme që organizatat me mjete të kufizuara kanë nevojë të vlerësojnë se si mund të shpenzojnë më mirë paratë, që në disa raste, mund edhe të nënkuptojë ndalimin e ndihmës për dikë, që nuk është i përkushtuar ndaj programit. Në të njëjtën kohë, mbetet një çështje e hapur se sa transparente janë rregullat e programit dhe sa e qartë është për përfitueset, se ekzistojnë “shkelje” për të cilat mund të përjashtohesh nga ndihma. Në disa raste, viktimat janë përjashtuar nga ndihma pa e kuptuar plotësisht se zgjedhjet, si për shembull, udhëtimi jashtë gjatë marrjes së ndihmës shkelte rregullat e programit. Për të parandaluar keq-komunikimin dhe të kuptuarit e ndryshëm, rregulla dhe parametra të qarta për ndihmën janë të nevojshme, përfshirë edhe çfarë përbën një shkelje.

Gjithashtu e rëndësishme është se çfarë pritet në lidhje me përpjekjet dhe zhvillimin e vetë përfituesve në një program ndihme. Shumë organizata e kanë të qartë se çfarë duhet të bëhen përfitueset, duke ngritur kështu çështjen, se çfarë sjelljesh kërkohen dhe janë të privileguara – p.sh. të jesh “vajzë e mirë”, të zësh vend e të martohesh e t'u japësh fund të gjitha aspiratave për të emigruar. Nëse viktimat janë të detyruara të përshtaten me një identitet që nuk është në përputhje me mënyrën se si ato e shohin veten apo se kush duan të bëhen, ato mund të zgjedhin refuzimin. Në të njëjtën kohë, disa viktima mund të marrin përkohësisht këtë identitet, që ta bëjnë më të lehtë aksesin ndaj shërbimeve, çka është gjithashtu e ndërlikuar.

Kushte dhe kufizime stresuese

Shumë strehëza kanë rregulla dhe kufizime të rrepta. Deri diku kjo gjë është e nevojshme në ambiente ku të panjohura shpesh të traumatizuara jetojnë së bashku. Disa gra dhe vajza mund të jenë gjithashtu subjekt i kërcënimeve dhe raprezajleve, dhe, si rrjedhojë kanë nevojë për mbrojtje. Megjithatë, në shumë raste, kufizimet janë të tepruara dhe për shumë viktima të ndihmuara ato ishin të vështira dhe stresuese. Strehëzat shpesh janë të tipit të ashtuquajtur “të mbyllura”, çka nënkupton se banoret kanë pak ose aspak liri lëvizje dhe duhet të shoqërohen kur janë jashtë strehëzës. Në fillim ky tip strehëze u ngrit për të akomoduar ose përfituese të huaja (d.m.th me qëndrim të jashtëligjshëm në vend, ndërsa jepej ndihma emergjente dhe përpunoheshin dokumentat e kthimit) ose për raste me rrezik të lartë (d.m.th në nevojë për mbrojtje të vazhdueshme). Gjithsesi, modeli përdoret më gjerësisht në vendet e origjinës dhe destinacionit, shpesh rreziqet e sigurisë përdoren si shpjegim.

Një viktimë shpjegoi se si kufizimet ishin të vështira për t'u përballuar:

Mendoj se gjëja e parë është liria. Për dy muaj dhe dy javë, kam qenë e mbyllur brenda katër mureve. E përplasja kokën tek kaloriferi dhe i gjuaja muret me grushte. Thjesht po çmendesha. Kur fola me drejtoreshën dhe ajo më tha, se supozohej, se do të qëndroja për dy ose tre muaj, u shkatërrova.

Kufizimet e tjera janë të lidhura me përdorimin e telefonave (celularët personalë shpesh janë të ndaluar dhe telefonatat bëhen nën mbikëqyrjen e personelit) e shpesh shpjegohen duke ju referuar shqetësimeve për sigurinë. Është e kuptueshme që strehëzat janë të shqetësuara për sigurinë, por është e diskutueshme nëse kjo është mënyra më efikase për të mbrojtur viktimat, veçanërisht nëse marrim në konsideratë koston personale të këtyre masave. Më tej, strehëzat që veprojnë pa këto kufizime kanë raportuar më shumë probleme sesa strehëzat e modeleve të mbyllura, edhe kur profilet dhe përvojat e përfitueses janë të njëjta. Një punonjëse sociale në një strehëz të hapur theksoi edhe disavantazhet që mbartin kufizimet: “Këtu ne merremi me rehabilitimin dhe ri-integrimin e personit në shoqëri. Nëse viktima mbahej e kyçur kur ishte e trafikuar dhe mbyllet përsëri këtu, për çfarë lloj ri-integrimi mund të flasim?”

Paragjykimet dhe ndjeshmëritë

Midis përfitueseve dhe ofruesve të shërbimit ka një ndryshim të dukshëm autoriteti që duhet të negociohet me kujdes. Shumë ofrues shërbimesh e trajtojnë këtë me kujdes dhe me vetëdije. Por, në disa raste, kufijtë kapërcehen e gratë kanë raportuar sjellje problematike nga ana e stafit të programit. Një vajzë e re na tregoi për qëndrimin e saj në një strehëz, nga e cila ajo u largua vetë më vonë:

[...] Nuk më pëlqente një nga anëtarët e stafit. Kishim një banjë dhe një vajzë ishte e sëmurë e nuk na treguan, që një vajzë ishte e sëmurë dhe e pyeta [punonjësen sociale] pse nuk na thonë edhe neve, se kisha frikë se mos ishte ngjitesë... Dhe [punonjësja sociale] më tha se ti nuk [mesa duket shqetësoheshe për] këtë sëmundje kur flije me meshkujt, kështu që pse na bezdis tani. Dhe unë i thashë, se ajo e dinte se si unë

kisha përfunduar në këtë situatë... U ndjeva shumë keq dhe e gjykuar. Ata kishin dijeni për problemet e mia dhe mendoja se stafi e kuptonte.

Ky lloj trajtimi ngre disa shqetësime serioze për qëndrimin dhe paragjykimet e disa ofruesve të shërbimit. Një problem mund të jetë se ndihma për viktimat e trafikimit, në shumë raste, drejtohet nga OJQ, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të monitoruara për sa i përket zbatimit të programit; nuk ju kërkohet të respektojnë standarde të vendosura të përkujdesjes; dhe në përgjithësi nuk i japin llogari ndonjë institucioni në lidhje me cilësinë e shërbimeve. Kjo nënkupton se ndihma ndaj viktimave merr formën e bamirësisë, e cila është e modeluar sipas idesë se “një dhënësi dashamirës”. Kjo nuk do të thotë se organizatat abuzojnë rregullisht me autoritetin duke refuzuar viktimat që nuk ju pëlqejnë ose që janë sfiduese për t’i ndihmuar. Gjithsesi, meqenëse asistencë ndaj viktimave të trafikimit mbetet akoma kryesisht fusha e OJQ-ve, disa me personel idealist dhe të mbingarkuar me punë, mund të kontribuojnë në imazhin që shumë viktima e kanë, se ndihma nuk është domosdoshmërisht diçka që ato kanë të drejtë ta marrin. Për më tepër, struktura aktuale jashtë organeve shtetërore nënkupton, gjithashtu, se nuk ka mekanizma formal për ankesa në rastin e keqtrajtit ose neglizhencës. Edhe pse nuk sugjerojmë që paragjykimet dhe sjellja e paragjykuar është diçka e zakonshme në strehëza apo në programet e ndihmës, kjo është një çështje që është ngritur nga disa informatorë kyç, dhe për rrjedhojë, e përligj shqetësimin.

Nuk mund të refuzosh çka nuk të ofrohet

Një çështje qendrore është se kujt i ofrohet ndihma në radhë të parë. Shumë gra të shfrytëzuara për prostitucion në vendin e tyre mund të klasifikohen brenda përkufizimit të viktimave të trafikimit dhe, si të tilla, e gëzojnë të drejtën e ndihmës. Megjithatë, ky grup nuk konsiderohet gjithnjë si i tillë apo t’i ofrohet ndihmë në mënyrë sistematike.

Intervistat me 20 prostituta rrugësh në Beograd na treguan për shtatë raste kur hyrja në prostitucion ishte dukshëm trafikim. Një prostitutë minorene na tregoi, se në moshën njëmbëdhjetë vjeçare, u shit nga xhaxhai tek një burrë, që e kishte detyruar të qëndronte me të për një vit. Gjatë asaj kohe ajo ishte detyruar të bënte seks me klientë dhe drogohej rregullisht me alkool, kokainë dhe tableta ekstaze që të siguronin pranimin e saj të heshtur. Një nga klientët e saj të rregullt e kishte ndihmuar të arratisej, por burri që e kishte blerë i erdhi në shtëpi e kishte rrahur vajzën, nënën dhe gjyshen e saj dhe i kishte kërcënuar se do t’i vriste dhe i kishte plaçkitur. Vajza qëndroi në shtëpi edhe për një kohë, por, ndërsa tensioni në familje rritej, më së fundi ajo ju kthye prostitucionit.

Gratë dhe vajzat në këtë kategori nuk iu ishte ofruar sistematikisht ndihma në dispozicion të viktimave të trafikimit. Kjo ndodh, të paktën pjesërisht, sepse disa subjekte të ndryshme të zbatimit të ligjit punojnë me prostitutat në bazë të një trajtimi të ndryshëm në lidhje me trafikimin dhe objektiva të ndryshëm. Në Serbi, për shembull, ndërsa policia kundër-trafikimit në përgjithësi merret me viktimat e trafikimit, policia e rendit publik merret me prostitucionin lokal në rrugë. Nëse marrëdhëniet me policinë nuk ishin të mira – shumë prostituta rrugësh kanë raportuar abuzime dhe shkelje nga

ana e policisë – ka shumë mundësi që prostitutat (të trafikuar ose jo) nuk do të kërkojnë ose pranojnë ndihmën e ofruar nga ata.

Për momentin, ka një dallim të qartë midis trafikimit të jashtëm dhe atij të brendshëm për sa i përket se kujt i ofrohet ndihma dhe se si policia trajton viktimat. Ndërsa disa të ashtuquajtura viktime të mundshme të trafikimit (d.m.th gra dhe vajza që janë zbuluar para se të shfrytëzoheshin) janë regjistruar në programe ndihme, viktimave të trafikimit të brendshëm në tregjet lokale të prostitucionit rrallëherë ju është ofruar ndonjë ndihmë.

Një kulturë mirënjohje apo përzgjedhje e paragjykuar në studimin e trafikimit?

Analiza e modeleve të pranimit dhe refuzimit të ndihmës është e vështirë për shkak të asaj që mund të përshkruhet si një “kulturë mirënjohje” midis viktimave të ndihmuara të trafikimit, të paktën, midis atyre me të cilat shumica e organizatave janë të gatshme të lehtësojnë kontaktimin. Madje edhe në rastet kur organizatat kanë thënë se viktimat kanë qenë të pakënaqura me shërbimet, ato shpesh kanë hezituuar ta pranojnë këtë kur janë intervistuar. Në fakt, ato kanë qenë më shumë të sinqerta seç duhet për abuzimet seksuale apo dhunën, që në fakt duken çështje më të ndjeshme. Një vajzë e re na tregoi për zhgënjimin kur ndihma e premtuar nuk ishte bërë konkrete, por nuk na i shpjegonte pse ishte kështu, në vend të kësaj theksoi se e kuptonte që nuk mund të merrte ndihmën e premtuar. Ajo ishte, sikurse u shpreh, mirënjohëse për çka kishte marrë. Gra të tjera që nuk kishin marrë ndihmën e premtuar, gjithashtu luhateshin midis kësaj mirënjohje këmbëngulëse dhe zhgënjimit.

Kishte disa përjashtime në këtë model. Një grua ishte e irrituar dhe e zhgënjyer me ndihmën që kishte marrë (apo nuk kishte marrë) dhe në disa pjesë të intervistës ishte shumë e shqetësuar. Punonjësja sociale na vuri në kontakt me të pikërisht për të theksuar se jo të gjitha klientët janë të kënaqura: “I [kërkova të marrë pjesë] sepse nuk mendoj se është e drejtë të themi, se kemi viktime dhe po i ndihmojmë, kështu që çdo gjë po shkon në rregull, sepse në të vërtetë nuk është kështu”. Kjo lë të kuptohet, se disa ofrues shërbimesh mund të mos lehtësojnë aksesin ndaj përfitueseve më pak të kënaqura dhe ajo çka mund të duket si një mirënjohje e qëndrueshme për shërbimet, mund të rrjedhë nga përzgjedhjet e paragjykuara në lidhje me aksesin që ofruesit e shërbimeve mund të lehtësojnë.

Viktimat janë të prirura të mendojnë, se ndihma është për shkak të vullnetit të mirë të individëve sesa shërbime që ato kanë të drejtë, nga organizata të përgjegjshme me detyrime brenda kuadrit shoqëror dhe si një organizatë e shoqërisë civile. Kjo çështje e llogaridhënies dhe transparencës është thelbësore. Ofruesit e shërbimit duhet të japin llogari për sa i përket dhënies së një përkujdesjeje brenda standardit të përcaktuar dhe të përdorë një lloj profesionalizmi. Një nga mekanizmat aktual të llogaridhënies – donatarët – nuk është e mjaftueshme, pasi donatorët mund të kenë kritere të kufizuara për atë që mund të konsiderohet si “ndihmë e suksesshme”.

Pjesa IV: Konteksti shoqëror dhe përvoja personale si pengesa për pranimin e ndihmës

Përmbledhje: Për shumë viktima, vendimet për refuzimin ishin një produkt i gjendjes së tyre individuale e shoqërore dhe lidhet me çështjet në vijim:

- **Besimi.** Besimi ishte kryesori në vendimet për ndihmën; refuzimi në disa raste ishte si rrjedhojë e dyshimit të viktimit ndaj disa formave të ndihmës – për shembull, grantet e biznesit (dhe nëse do të kishte kosto të fshehura ose borxhe), ndihma psikologjike, mbështetja ligjore etj. Përvojat negative me ndihmën, si të një natyre të përgjithshme ashtu dhe të lidhur posaçërisht me pas-trafikimin, ndikonin tek niveli i besimit të viktimit ndaj atyre që u ofrohej.
- **Aspekte të ndryshme të stigmës dhe përjashtimit.** Për disa, frika se mos stigmatizoheshin si viktimit e trafikimit gjithashtu luante një rol në procesin e vendim-marrjes. Ndihma, që e identifikon viktimit si të trafikuar, mund të ketë pasoja të rënda. Stigma lidhet me prositucionin por edhe me të qenurit një emigrante e dështuar që nuk kishte sjellë para në shtëpi. Situata për viktimit që ishin të stigmatizuara me sa duket përmirësohet me kalimin e kohës, veçanërisht kur viktimit modifikonin sjelljen e tyre në mënyrë të tillë që të ingranoheshin me normat dhe pritshmëritë shoqërore ose kur ja dilnin të kishin sukses në fusha të tjera.
- **Identifikimi me rolin e viktimit.** Për disa, identiteti i viktimit nuk shkonte me perceptimin e imazhit për veten dhe refuzimi i ndihmës, në thelb, ishte refuzimi i këtij identiteti. Shumica ishin mësuar të kujdeseshin jo vetëm për veten por edhe për familjet e tyre dhe dëshira për të mbështetur familjet ishte motivimi për emigracion. Të tjerat kishin probleme në lidhje me rolin e “viktimit së trafikimit” duke mos parë shfrytëzimin/emigrimin e tyre “aq të keq” sa të përlligjte ndihmën. Megjithatë, të tjera e përqaftuan rolin e viktimit. Por, ndonjëherë kjo çoi në pritshmëri të larta për atë që duhet të ofrohej, dhe më pas zhgënjim, ku disa viktimit largoheshin nga programet.

10. Besimi

Çështja e besimit përforcon të gjitha gjetjet tona; ai luan një rol kryesor në vendimet për të pranuar ose jo ndihmën. Besimi është në themel të punës që organizatat e ndihmës kryejnë, kur ju kërkojnë viktimave të trafikimit të hyjnë në programe të panjohura ose të vendosen në strehëza që nuk kanë qenë më parë. Megjithatë, ka dy aspekte të veçanta të besimit të cilat ishin çështje në vetvete – dyshimi për ndihmën dhe përvojat e kaluara të ndihmës.

Dyshimi për disa forma të ndihmës

Disa viktimat janë dyshuese për disa forma të ndihmës, që nuk mund të vlerësohen në shoqëri ose që kanë asosacione negative për disa njerëz. Shumë viktimat kanë shprehur të paktën dyshime dhe pasiguri për lloje të ndryshme të ndërhyrjes dhe ndihmës.

Familjet e viktimave kanë qenë shpesh dyshuese. Bashkëshorti i një viktime e dekurajoi atë që të mos kërkonte ndihmë, dyshues se ndihmat nuk do të ishin falas dhe do t'ju kushtonin disi më vonë. Kur ajo mori një grant biznesi pas disa muajsh ndihme në forma të tjera (pozitive dhe falas), ai përsëri ishte dyshues madje dhe në kohën e intervistës nuk kishte ndryshuar mendim.

Dyshimi mund të jetë gjithashtu një pengesë më e madhe për disa forma të ndihmës se të tjerat, ofruesit e shërbimeve kanë vënë re, në veçanti, rezistencën ndaj ndihmës psikologjike dhe ligjore.

Besimi është thelbësor në adresimin e dyshimit, sikurse vëren një ofrues shërbimi:

Në shumë raste kur viktimat e trafikimit na marrin në telefon e kanë marrë numrin nga shoqet. Dhe nëse dikush që ato besojnë i japin numrin, varet gjithashtu dhe nga mënyra, se si ky person i shpjegon shërbimet. Numri ynë jepet nga përfaqësuesit e ambasadave, policisë, priftërinjtë, OJQ-të, agjencitë e punësimit, dhe në këto raste kur kemi ndërmjetësues nuk kemi probleme me besimin.

Besimi shpesh ka të bëjë me një individ të veçantë ose organizatë. Kjo dinamikë ndërlikon referimet kur ndihma dhe shërbimet duhet të aksesohen nga organizata të tjera, të cilat dhe njëherë duhet të kapërcejnë këto dyshime.

Përvoja të kaluara me ndihmën

Disa viktimat e refuzojnë ndihmën për shkak të përvojave negative të kaluara – ndonjëherë brenda kuadrit të ndihmës pas-trafikimit, ndonjëherë e më gjerë.

Përvoja negative të ndihmës u vunë re në sektorë të ndryshëm në secilin prej tre vendeve. Një doktor shpjegoi për përvojën e keqe dhe traumatike të një gruaje kur po testohej për HIV/SIDA. Me testin e parë pozitiv, një letër u dërgua tek klinika lokale shëndetësore që i kërkonte të bënte një test të dytë:

... më së fundi mjeku i familjes, punonjësja sociale, policia dhe të gjithë komshinjtë i vajtën në shtëpi që t'i thonin për testin e dytë të HIV-it, që në fund doli negativ. Kështu që ishte me të vërtetë, me të vërtetë e tmerrshme. Sigurisht ishte një shkelje e konfidencialitetit e me radhë. Është një problem serioz veçanërisht në fshatra të vegjël...

Kjo përvojë mund të ndikojë arsyeshëm në gatishmërinë e gruas për të marrë ndihmë në të ardhmen. Në këtë rast ajo vazhdoi të pranonte ndihmën, por sikurse u shpreh psikologu i saj, vetëm se kishte nevojë: “Nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për të. Ajo nuk mund të merrte ndonjë gjë tjetër nga vende të tjera”.

Në mënyrë të ngjashme, (keq)trajtimi i rasteve në vendet e destinacionit gjithashtu mund të çojë në hezitimin për të aksesuar ose pranuar ndihmën në vendet e origjinës. Merr, për shembull, rastin e tre grave që ishin ndihmuar në një strehëz dhe kishin rënë dakord të dëshmonin kundër trafikuesit të tyre dhe si rezultat vetëm vonuan kthimin e tyre në shtëpi për disa muaj. Policia nuk u dha as vizat e daljes në kohën e duhur (një proces që në përgjithësi merr vetëm disa ditë) dhe as nuk i lejuan viktimat të shkonin në shtëpi, ndërsa çështja po përgatitej, edhe pse kishin rëndë dakord të ktheheshin e të dëshmonin. Vonesa u shkaktua edhe sepse gjykatësi kryesues nuk erdhi në gjyq dy herë. Familjet e grave që prisnin për to në shtëpi, ishin shumë të stresuar nga kjo vonesë. Ajo që duhet vënë re është se trafikuesi i dyshuar ishte arrestuar, ndaluar dhe deportuar shumë më parë se viktimat “e ndihmuara”.

Intervistat me prostitutat e rrugëve në Beograd (përfshirë edhe shtatë viktima të trafikuar) u shprehën se ndërveprimet negative me policinë – p.sh. abuzimet dhe ngacmimet, të detyruara t’u ofronin policëve shërbime seksuale, të arrestuara, të zhvatura për para, mbrojtjen e mohuar nga klientët dhe tutorët – ndikuan në gatishmërinë e tyre për t’ju drejtuar policisë në raste vështirësie. Gjasat që këto gra do të pranojnë ndihmën janë të pakta, veçanërisht kur pika e parë e kontaktit ka mundësi të jetë policia.

Sikurse u përmend në kapitullin e mëparshëm, viktimat e trafikimit të brendshëm në Beograd raportuan një mosbesim të fortë ndaj policisë dhe ka të ngjarë të mos kërkonin ndihmë. Grupe të tjera të marxhinalizuara – për shembull, minoritetet etnike – gjithashtu mund të ndihen të ngurruara për shkak të përvojave të kaluara negative, sikurse vuri në dukje një aktor i kundër-trafikimit:

Romët, ky është një grup që nuk kanë po aq referime ose të kërkojnë ndihmë. Nuk jam i sigurt nëse mungojnë referimet sepse [Romët] janë shumë të marxhinalizuar. Nëse nuk janë ndihmuar ndonjëherë më parë nga shteti, vetëm sa janë stigmatizuar nga ai, pse do ta kërkonin atë tani kur janë përballë një traumë kaq të tmerrshme?

Ana tjetër është se disa gra dhe vajza kanë pasur një përvojë ndihme shumë pozitive në vendin e destinacionit dhe si rezultat, janë të pakënaqura me nivelin e kujdesit që ato kanë marrë në vendin e origjinës. Si konkluzion, është mirë të merret në konsideratë shkalla e pranimin të ndihmës, kur rastet janë si rezultat i përvojave të kaluara pozitive.

11. Stigma dhe përjashtimi

Disa viktime mund ta refuzojnë ndihmën se kanë frikë nga stigma dhe përjashtimi shoqëror – çështje që lidhen me faktorë të ndryshëm. Stigma mund të ndikojë jo vetëm tek individi, por mund edhe të shtrihet tek familjet e madje tek komuniteti lokal.

Kur ndihma i identifikon viktimat në komunitet

Marrja e ndihmës nga organizatat kundër-trafikimit mund t'i identifikojë gratë si viktime të trafikimit (të konsideruara nga shumica si “devijuese”) dhe si rrjedhojë, çojnë në stigmatizim sikurse e ka shpjeguar një punonjëse sociale:

Shumica kanë frikë se ambienti përreth do ta zbulojë – sa herë që një grua merr ndonjë ndihmë bëhet dyshuese ndaj ambientit, kështu që ato mendojnë, se është më e sigurt të mos marrin asnjë ndihmë. Ato duan të fshihen nga familjet dhe miqtë e tyre në qytete të vogla.

Stigma mund të shtrihet tek e gjithë familja. Një viktimë e kthyer u refuzua nga familja, se u vinte turp nga prostitucioni i saj dhe nga frika se mos kushërirat e saj nuk do të martoheshin për pasojë. Forma të veçanta të ndihmës mund të jenë veçanërisht të identifikueshme. Dihet se disa organizata punojnë kundër-trafikimit, të tjera organizojnë takime dhe marrin personat e trafikuar, në mënyrë të tillë, që mund t'i identifikojë ato tek të tjerë të pranishëm (për shembull, veshja e bluzave të organizatës dhe simboleve). Viktimat gjithashtu mund të “veçohen” me mënyra të tjera – duke i takuar në komunitete, nga hetimet e policisë në komunitete ose shoqërimi me organizata të veçanta. Ambientet e banimit mund të jenë edhe identifikues kyç në vendet ku institucionet nuk janë pjesë e kuadrit të ndihmës ose ku njerëzit kanë përvoja negative të kujdesit rezidencial, duke e përdorur vetëm në rast urgjencash.

Kjo thekson nevojën për ndërhyrje më pak të dukshme si dhe avantazhin strategjik për të ndihmuar komunitetet sesa të vësh në shënjestër individët ose familjet. Disa programe janë dizenuar posaçërisht për të lehtësuar rrezikun e identifikimit nga grupet shoqërore të cënueshme përfshirë, por jo të kufizuara vetëm tek viktimat e trafikimit.

Çfarë lloj sjelljesh janë të stigmatizuara?

Te kuptosh rolin e stigmës në vendimet për refuzimin e ndihmës kërkon shkoklavitjen se si stigma ndërthuret me trafikimin. Ndërsa prostitucioni përmendet si burimi më i zakonshëm i stigmës, tjetër burim është emigracioni i dështuar. Dhe shkaqet e stigmës nuk janë të dallueshme, por më tepër përforcojnë njëra-tjetrën. Kur gratë kthehen me pak ose aspak para, kjo gjë është e vështirë të fshihet, dhe në të njëjtën kohë, emigracioni i dështuar mund të shoqërohet me të qenurit e trafikuar për prostitucion. Ekuilibri për emigrantet femra të kthyer është gjithashtu i hollë, pasi dhe kthimi me shumë para mund të jetë gjithashtu problem, duke i etiketuar si prostituta të suksesshme.

Stigma për shkak të prostitucionit

Në të tre vendet e studiuara, prostitucioni nuk ishte as i ligjshëm por as nuk falej nga shoqëria. Stigma nuk shfaqet vetëm në shoqëri por mund të ketë edhe pasoja fizike reale. Një psikolog shpjegonte se si një viktimë u brutalizua në komunitetin e saj për shkak të stigmës që shoqërohej me prostitucionin e saj (të detyruar):

“[Ajo] nuk tregoi gjë, por kishte shumë njerëz, që dyshonin, se ajo kishte qenë larg për katë vite. Ajo shkoi në një mbrëmje në fshat dhe djemtë atje e nxorën jashtë dhe e përthunuan – ‘ti ishe atje dhe e bërë këtë për para, pse nuk e bën për ne pa para’”.

Njohja e historisë së plotë të viktimizimit të një individi nuk shërben gjithnjë (ose madje shpesh) për të lehtësuar stigmën që shoqërohet me prostitucionin (e detyruar).

Frika nga stigma mund të çojë viktimat dhe familjet e tyre të refuzojnë ndihmën, dhe të paktën në një rast, kishte pasoja fatale. Një OJQ tregoi se si një baba u ishte afruar pasi kishte dëgjuar për organizatën në radio. Vajza e tij ishte kthyer nga trafikimi shumë e sëmurë dhe ata kishin harxhuar pothuajse të gjitha paratë për trajtimin e saj, por pa asnjë shenjë përmirësimi. Babai ngulte këmbë që ata të merrnin ndihmë, por gruaja dhe vajza e ti refuzonin në mënyrë kategorike. Me kalimin e kohës, gruaja ra dakord të merrte ndihmën, të paktën për shkak të faktit se familja nuk mund ta përballonte më trajtimin mjekësor. Që trajtimi u bë në kryeqytet (jo në qytetin e tyre) mund edhe të ketë ndikuar në pranimin e ndihmës, sikurse bëri dhe zhvillimi gradual i besimit tek ofruesi i shërbimit. Trajtkishtë, trajtimi erdhi me vonesë dhe vajza vdiq.

Stigma për shkak të emigracionit të dështuar, mosarritja e fitimit të parave

Duke parë rëndësinë e emigracionit si një strategji ekonomike (dhe madje për mbijetesë familjare), emigracioni i dështuar mund të çojë në stigmatizim. Kjo përkeqësohet dhe nga shumë “histori të suksesshme emigracioni” të cilat qarkullojnë në komunitetet dërguese, heshturazi nënkupton se një emigrant është i paaftë nëse ai ose ajo kishte dështuar ndërsa shumë të tjerë kanë pasur sukses.

Viktimat e huaja thuhet se stresohen nga qëndrimet e gjata në strehëz (në përgjithësi për shkak të përfshirjes në procedurat penale kundër trafikuesve të tyre) sepse, të paktën, ishte e vështirë t’u shpjegonin familjeve të tyre pse nuk po ktheheshin dhe/ose nuk po dërgonin para. Marrja e ndihmës, atëherë, mund të nxjerrë në pah ndoshta dështimin e emigrantit dhe çon në stigmatizim.

Borxhi i marrë për të financuar emigrimin mund të rrisë zemërimin dhe frikën kur një grua kthehet pa para, duke mos qenë në gjendje të ri-paguajë borxhin. Kjo mund të çojë në një stigmë më të madhe për gruan, e cila, nëpërmjet “dështimit” të saj e ka shtuar sesa shëruar cënueshmërinë ekonomike të familjes. Borxhi mund të bëjë që viktimat të emigrojnë përsëri, duke i ekspozuar ndaj më shumë rreziqeve dhe mundësisë për ri-trafikim.

Sjellje që lehtësojnë stigmën

Ndërsa për shumë viktime stigmatizimi ishte i pashmangshëm, nuk dukej si i pakthyeshëm. Viktimat e ri-integruara raportuan se shpesh ishte një çështje kohe – dy deri në tre vjet – para se komuniteti t’i pranonte dhe t’i trajtonte normalisht. Një viktimitë që u kthye në komunitetin e saj shmangej sa herë që shkonte në dyqanin e fshatit, ky lloj trajtimi vazhdoi për dy vjet derisa situata më në fund u normalizua.

Disa sjellje mund të lehtësojnë stigmën, si rrjedhojë lejojnë që familja ose komuniteti “të fal”. Ri-integrimi i pranueshëm kulturor në komunitet kërkon një shqyrtim të pengesave shoqërore dhe lehtësuesve për ri-integrimin e suksesshëm. Në një komunitet konservator, një organizatë lokale argumentonte se “gjëja më e rëndësishme është që ajo të kuptojë gabimin e saj” dhe “të ndryshojë sjelljen”, duke sugjeruar se përshtatja e sjelljes së saj (përfshirë gjuhën, pamjen e jashtme, qëndrimin dhe veprimet) ndaj kushteve lokale është e mjaftueshme të kundërveprosh ndaj stigmës. Emëruesit e përbashkët duket se janë sjelljet e ndryshuara si dhe suksesi përta i përket gjenerimit të të ardhurave, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes së alternativave të jetesës si pjesë e përpjekjeve të ri-integrimit.

12. Identifikimi me rolin e viktimës

Pranimi i ndihmës shpesh ndryshon rrënjësisht imazhin e përfitueses për veten e saj. Shumë të intervistuar folën për identitetin e tyre ndërsa shpjegonin alternativat e tyre të ndryshme në lidhje me ndihmën. Shumë folën edhe për një ndryshim se si ato e shihnin veten pasi kishin pranuar ndihmën – për shembull, që ato kishin më besim në vete, se ato e dinin, se meritonin më mirë sesa abuzimi që kishin vuajtur, se ato nuk ndiheshin më me faj ose inferiore. Megjithatë, për të tjerat, panorama ishte më e ndërlikuar dhe jo gjithnjë plotësisht pozitive. Pranimi i ndihmës nënkupton pranimin e rolit dhe identitetit të viktimës së trafikuar, e cila është shumë dimensionale dhe mban elementë në dukje kontradiktorë. Nga njëra anë, viktimat e trafikimit stigmatizohen shpesh, ndërsa, nga ana tjetër, retorika që rrethon çështjen ndonjëherë përfshin një shkarkim të fajit ndaj viktimave. Për këtë arsye, nuk është një rol i lehtë për t’u marrë. Për më tepër, të pranosh ndihmën, përfshin, deri në një nivel, pranimin e rëndësisë së asaj që ka ndodhur, e cila, në vetvete mund të jetë e vështirë kur shumë viktime përballen me traumën duke e shtypur dhe mohuar.

Në lidhje me termin e trafikimit

Ndërsa përkufizimi i trafikimit nuk kufizohet vetëm për prostitucionin e detyruar, ideja, që shumica e “viktimave të vërteta” janë në prostitucion kundër vullnetit të tyre, akoma mbizotëron. Kur u pyetën se kush është një viktimitë trafikimi dhe nëse ato mbajnë ndonjë përgjegjësi për shfrytëzimin e tyre, pjesa më e madhe e përfaqësuesve institucionalë thanë, se nuk ka rëndësi nëse një viktimitë ra dakord për prostitucion, nëse ajo është shfrytëzuar, nuk duhet të fajësohet apo të stigmatizohet dhe përgjegjësia bie

mbi trafikuesit. Megjithatë, një tjetër tablo qëndrimesh del në pah, kur çështja hulumtohet në më shumë detaje me informatorë kryesorë. Duke marrë parasysh pohimin e një oficeri policie, i cili më parë kishte shprehur mënyrën e tij të të kuptuarit të trafikimit të grave, sikurse u tha më sipër, d.m.th që nuk kishte rëndësi nëse viktimat kishin hyrë në prostitucion me dashje apo jo:

Shumica e atyre që pretendojnë se janë viktimat të trafikimit kanë ikur me dëshirën e tyre, dhe arsyeja që ato akuzojnë trafikuesit është se [trafikuesi] prishi marrëveshjen e tyre. (...) Ndonjëherë viktimat e kanë përdorur policinë për të bërë marrëveshje me të mira me trafikuesit. (...) Nuk mund të themi se janë viktimat në përkufizimin e duhur të fjalës. (...) Ato nuk u rrëmbyen dhe u detyruan.

Kjo ilustron se si viktimat e trafikimit mund të klasifikohen si më shumë ose më pak të justifikuar, ose madje si “të pastra”, në varësi se sa e vullnetshme ishte hyrja e tyre në prostitucion. Ky mendim është thujtë i përbashkët midis zbatuesve të ligjit dhe ofruesve të shërbimit.

Për më tepër, ky kuptim i trafikimit të grave reflektohet gjithashtu midis vetë viktimave të trafikimit. Shumë që do të përkufizoheshin si viktimat nga legjislacione kombëtare dhe ndërkombëtare nuk do ta përkufizonin veten në këtë mënyrë. Për shembull, në intervistua disa minorene të shfrytëzuara për prostitucion (të cilat, në vetvete, klasifikohen si të trafikuarat) dhe, për më tepër, kishin edhe pika të tjera të dobëta kur u rekrutuan për prostitucion. Gjithsesi, disa nuk e panë veten si të trafikuarat, dhe, për rrjedhojë, pyetën pse duhet të merrnin ndihmën e pas-trafikimit.

Imzhi i trafikimit si prostitucion i detyruar –kush “detyrohet mjaftueshëm”?

Disa viktimat të trafikimit gjykonin se ndihma është për ato që kanë qenë “më të detyruara” se ato vetë; të tjera mendonin, se përfshirja romantike me trafikuesin nënkupton, se ato nuk janë në të vërtetë viktimat. Në të njëjtën kohë, një nga mënyrat më të raportuara të rekrutimit dhe kontrollit nga trafikuesit është pikërisht të trillosh një marrëdhënie intime me viktimën. Edhe pse “i Rozës” e trafikoi, shfrytëzoi atë për prostitucion, e çoi në qytet tjetër, kur ajo u kontaktua nga punonjësit në terren, e përdori atë për kontrabandë droge, e kërcënoi atë dhe familjen e kështu me radhë, ajo përsëri deklaronte: “Ai nuk është fajtor [për trafikimin] në rastin tim. Nuk do ta denoncoj në polici pasi u largova vetë me dëshirë”. Dashuria për këtë burrë nënkuptonte se ajo nuk i shihte veprimet e tij si trafikim (apo veten e saj si një viktimë).

Shumë viktimat të trafikimit janë të detyruara të futen në atë situatë, jo domosdoshmërisht nga një person tjetër, por nga rrethanat ku e gjejnë veten. Këto raste shfaqin sfida të veçanta për ata që i përket përkufizimit të trafikimit, pasi mund të jetë e vështirë të përcaktosh se ku përfundon rrethana fatkeqe dhe ku fillon manipulimi e shfrytëzimi. Gratë dhe vajzat mund të hezitojnë të kategorizojnë strategjitë e tyre të mbijetesës si viktimizim dhe, për rrjedhojë, mund të refuzojnë ndihmën specifike të pas-trafikimit.

Ishte diçka mjaft e zakonshme për viktimat e trafikimit të theksonin se ato nuk hynë në prostitucion me dëshirë. Disa të intervistuarat, që merrnin ndihmë, theksuan se si ato

ishin ndryshe nga gra të tjera, të cilat e dinin se ku po përfshiheshin. Atëherë, çështja qëndron se si do të ndihet dikush që ka hyrë në prostitucion me dëshirë dhe me vetëdije, por që përsëri është trafikuar, nëse ndihmohet përkrah atyre, historitë e të cilave përfshijnë rrëmbimet, detyrimin dhe dhunën. Ndërsa një grua mund ta ndjejë që ka qenë shfrytëzuar, është e zakonshme për viktimat e trafikimit të fajësojnë veten dhe të shikojnë veprimet e tyre për të shpjeguar se çfarë ka ndodhur, edhe pse kanë qenë subjekt i forcës, kërcënimeve apo mashtrimit.

Kur shfrytëzimi duket si mundësia më e mirë e disponueshme

Në lidhje me nëse dikush është “detyruar mjaftueshëm” është fakti, se disa gra dhe vajza mund të mendojnë, se situata e tyre mund të jetë marrëveshja më e mirë për të cilën ato mund të shpresojnë, nëse alternativa është të jenë në shtëpi (ndonjëherë në rrethana të vështira) dhe me asnjë mjet të ardhurash apo mundësish. Ndihma që i largon gratë nga “gjendja e punës”, edhe pse shfrytëzuese, mund të mos jetë gjithnjë një zgjidhje.

Një nga elementët kryesorë të përkufizimit të trafikimit është shfrytëzimi. Mund të ketë një përkufizim objektiv, për shembull, në fushat e rregulluara të jetës në punë, ku imponohen standardet minimale të pagës dhe kushteve të punës, dhe nëse thyhen këto rregullore mund të përkufizohet si shfrytëzim. Gjithsesi, prostitucioni në shumë vende është jashtë sferës së punës së rregulluar, çfarë nënkupton se koncepti i shfrytëzimit është edhe më subjektiv. Nëse personi ndihet i shfrytëzuar ose jo, shpesh ndryshon nga një person në tjetrin, edhe pse në rrethana të njëjta. Ka më shumë mundësi që njerëzit të pranojnë një situatë shfrytëzuese, nëse ka kushte të tjera që kompensojnë. Për shembull, një grua shumë e varfër që kthehej në shtëpi pasi ishte e detyruar të prostituonte fliste me mall se si, sa herë që ajo hapte frigoriferin kur ishte jashtë, kishte gjithnjë ushqim – “madje pulë”. Një faktor tjetër që mund të lehtësojë shfrytëzimin dhe shërben për të justifikuar situatën e dikujt është nëse të jepet mundësia që të bësh edhe shumë pak para.

Lidhja me rolin e përgjithshëm si viktimë

Roli i viktimës së trafikimit u diskutua gjerësisht me të intervistuarat, të gjitha e bënë lidhjen me këtë rol në mënyra të ndryshme – disa fillonin diskutimin nëse përkufizoheshin si një viktimë në përgjithësi, të tjerat ishin më pranuese.

Refuzimi i identitetit të viktimës

Pranimi i ndihmës nënkupton pranimin e identitetit të viktimës së trafikimit. Ndërsa ky status të jep disa të drejta, mund të jetë në kundërshtim me mënyrën se si individët e shohin veten. Disa e shihnin si problematike, që të ishin nga ana e marrjes së ndihmës pasi ato ishin mësuar që të siguronin gjërat për vete dhe ndihma i bënte të ndiheshin pasive. Ja si shpjegon një grua që kishte qenë në program për rreth një vit:

Ndonjëherë kisha ndjenjën se isha si invalide... Pse duhet të më ndihmojë dikush nëse kam këmbë, duar, kjo është e vetmja gjë që kam. Kjo ndihmë, për shembull, mu dha, por në fillim nuk u ndjeva mirë sepse isha mësuar të bëja çdo gjë vetë.

Shumë viktime të trafikimit emigruan që të përmirësonin jetën e tyre (dhe të familjes së tyre), çka është më larg se të jesh pasive. Për dikë që është kujdesur për të tjerët në mënyrë aktive, mund të jetë e vështirë të pranosh se ata vetë kanë nevojë për ndonjë ndihmë. Marrja e identitetit të viktimës mund, si rrjedhojë, të përjetohet si heqje dorë nga puna ose nga një imazh pozitiv për veten.

Gjithashtu, disa gra mund të dëshirojnë të distancojnë veten nga përvoja traumatike dhe të vazhdojnë me jetën e tyre. Një grua e rekrutuar nga një i afërm i familjes u përball me dhunë ekstreme dhe degradim ndërsa ishte e trafikuar. Në kohën e intervistës ajo po vuante akoma nga lëndimet fizike, e paaftë të punonte. Rekrutuesi i saj jetonte afër, një burim i konsiderueshëm stresi për të, por ajo nuk e kishte raportuar tek policia dhe as nuk kishte në plan ta bënte, për shkak të fjalëve të saj: “Thjesht dua të bëhem nënë”. Kjo mund të lexohet si një dëshirë për t’u larguar nga e kaluara e saj traumatike, për ta përjashtuar atë nga identiteti i saj dhe të zgjedhë një identitet më pozitiv, atë të nënës (në vend të viktimës). Viktima që ishin të traumatizuara rëndë pas përvojave brutale të trafikimit, ndonjëherë e refuzonin ndihmën si një përpjekje “thjesht për të lënë çdo gjë pas”.

Në disa raste, gratë përpiqeshin të zvogëlonin atë që kishin kaluar. Në disa mënyra, kjo mund të shihet si një formë mohimi, por mund të jetë edhe një mënyrë për të menaxhuar të kaluarën traumatike. Pranimi i ndihmës mund, në një farë mënyre, ta bëjë traumën të vërtetë.

Krahasimi i përvojave të tyre traumatike me të tjerat mund të funksionojë edhe si një mekanizëm përballjeje. Disa njerëz mendonin se ato nuk mund ta pranonin ndihmën për aq kohë sa ka të tjerë në situata më të këqija. Një grua që vinte nga gjendje shumë të vështira financiare e refuzoi ndihmën financiare për ri-vendosje (afërsisht 50USD) sepse mendonte, se të tjerat kishin më shumë nevojë për to sesa ajo.

Kishte edhe gra që mund të pranojnë se janë viktime, por mendonin se përvoja e tyre nuk ishte “aq e keqe” sa për të marrë ndihmë. Një grua kishte qenë e trafikuar pesë vite para dhe akoma vuante nga makthet. Ajo e dinte për ndihmën por mendonte se mund t’ia dilte mbanë vetë. Pasi erdhi më në fund për këshillim ajo i tha punonjësës sociale “pse vuajta për pesë vjet? E dija se ju ofronit ndihmë, por mendoja se rasti im nuk është si rastet më të këqija”.

Përqafimi i identitetit të viktimës

Njerëzit e menaxhojnë identitetet e viktimës në mënyra të ndryshme dhe disa viktime të trafikimit me sa duket kanë përqafuar statusin e tyre të viktimës. Ato shpesh ishin më të vogla, në fund të adoleshencës dhe në fillim të të njëzetave, dhe mbase kanë pasur më pak gjasa të zhvillojnë një imazh për veten të lidhur, të paktën pjesërisht, me përkujdesjen ndaj të tjerëve (disa që shumë gra dhe nëna më të vjetra e të pjekura e kishin bërë), kjo e bënte më të lehtë që ato të pranonin identitetin e viktimës.

Pranimi i një identiteti shumë të fortë të viktimës mund të çojë në pakënaqësi me ndihmën në dispozicion dhe ndonjëherë kjo e fundit të refuzojë. Kjo ndodh kur përfituesja pret të marrë më shumë sesa ajo me të drejtë duhet të marrë, sikurse e shpjegon një punonjëse sociale:

Ka një grup tjetër vajzash këtu, është sikur e gjithë bota ju detyrohet diçka atyre. Ato janë armiqësore, pa dëshirë që të ndryshojnë. Kjo armiqësi nuk u drejtohet individëve, por të gjithë botës. Ato thonë, “Duhet të më japësh punë, duhet të më mësosh”. Zakonisht nuk qëndrojnë gjatë.

Pranimi i identitetit të viktimës dhe duke pritur shumë nga ndihma mund të jetë gjithashtu pjesë e procesit të marrjes së ndihmës dhe zbulimit se çfarë mund të pritët. Ndërkohë që është e zakonshme për përfitueset të çuditën dhe të jenë mirënjohëse kur e kuptojnë se ndihma është reale, është gjithashtu mjaft e zakonshme që pritshmëritë të rriten me kalimin e kohës. Një punonjëse sociale përshkroi një model ku shumë viktima merrnin në telefon organizatën gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës, duke ju kërkuar gjëra gjithnjë e më shumë, dhe ndihmë për të zgjidhur problemet. Kjo shoqërohej shpesh me pakënaqësi, kur përfituesja mendonte se nuk kishte marrë ndihmë kur kishte pasur nevojë.

Përfundimi dhe rekomandimet

Viktimat e trafikimit e refuzojnë ndihmën për një mori arsyesh. Ato shpesh mendojnë se pranimit nuk është një alternativë reale për to, duke lënë shumë nevoja dhe probleme për ndihmë të pashërbyera. Në disa raste, kjo cënueshmëri e vazhduar dhe mungesa e ndihmës mund të jetë edhe baza për trafikimin e shfrytëzimin e vazhdueshëm. Ndërsa disa viktima e refuzojnë ndihmën sepse ato nuk dëshirojnë ose nuk kanë nevojë për ta pranuar atë, disa e refuzojnë për shkak të rrethanave personale, për shkak të trajtës së ndihmës dhe/ose për shkak të përvojës së tyre shoqërore e personale.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona përqendrohen në çfarë, mund të ndryshohet e përmirësohet për të rritur mundësinë, që viktimat e trafikimit mund të arrijnë ndihmën për të cilën kanë nevojë ose dëshirojnë. Adresimi i çështjeve në vijim, sipas mendimit tonë, mund të përkthehet në përmirësime të dukshme dhe, shpesh, të menjëhershme në ndihmën kundër-trafikimit në Evropën Juglindore si dhe më tutje. Gjithashtu, kjo do të thotë se viktimat që mund të mos e kishin pranuar ndihmën në kushte të tjera mund të jenë më të prirura për ta bërë këtë gjë.

Ofro informacion realist e të kuptueshëm

Viktimat kanë nevojë për informacion të qartë, të kuptueshëm dhe realist për alternativat e ndryshme të ndihmës si jashtë ashtu dhe kur të kthehen në shtëpi. Ky është një rast i mirë për dhënien e materialeve të shkruara (të përshtatshme për moshën, gjuhën dhe arsimin e viktimës), pasi në kontaktin e parë ato janë shpesh në një gjendje konfuzie dhe të traumatizuara dhe si rrjedhojë kanë një kapacitet të kufizuar për të shqyrtuar pasojat e pranimit apo refuzimit të ndihmës. Viktima mund t'i lexojë materialet e shkruara në një fazë më të mëvonshme dhe shpresojmë më të qëndrueshme, edhe pse ajo në fillim e ka refuzuar ndihmën.

Demonstro besueshmëri dhe vendosja e besimit

Ndërsa vendosja e besimit kërkon kohë, një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është dhënia e informacionit dhe ndihmës së besueshme. Për këtë arsye, një hap do të ishte identifikimi dhe zgjidhja e disa problemeve specifike të viktimave – për shembull, dokumentat, shqetësimet shëndetësore apo të të ushqyerit – në këtë mënyrë konfirmon se ndihma është reale, efikase dhe e besueshme. Ka ndodhur shpesh, se kur viktimat kanë marrë ndihmën e parë konkrete dhe të posaçme, ato filluan të kenë besim tek ofruesit e shërbimeve, kjo është në mënyrë të vazhdueshme më bindëse sesa thjesht t'i sigurosh për qëllimet e mira.

Merr parasysh rregullat dhe kufizimet nga këndvështrimi i viktimës

Përdorimi i çdo kufizimi duhet të shoqërohet nga një mbikëqyrje racionale e të rreptë dhe udhëzime, më tej duhet të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të individit dhe një trajtim etik. Për më tepër, është e nevojshme të dikutohet seriozisht, se cilat lloje të ndërhyrjes janë të përshtatshme për viktimat e trafikimit (dhe kur), çfarë efekti terapeutik synohet dhe efikasiteti i ndërhyrjeve për të arritur këtë qëllim. Nëse do të përdoren kufizime, është e nevojshme të ketë një organ formal ndaj të cilit organizatat do të japin llogari në rast abuzimi apo problemesh.

Nevoja për monitorim, llogaridhënie dhe siguri i cilësisë

Spektori i ndihmës anti-trafik drejtohet gjerësisht nga OJQ-të dhe Organizatat Ndërkombëtare dhe puna e tyre monitorohet pak nga qeveritë vendase dhe donatorët. Ndihma duhet të përfshijë sisteme për licensimin e ofruesve të shërbimit, monitorim të rregullt të programeve dhe mekanizmat e ankimit. Ndihma e trafikimit duhet të vlerësohet (përfshirë këtu çfarë funksionon ose jo) si në aspektin e ndikimeve afatshkurtra ashtu dhe ato më afatgjate. Megjithatë, vlerësimet nuk duhet të shikojnë vetëm efektin tek viktimat e ndihmuara por edhe tek ato që nuk janë ndihmuar dhe pse? Çfarë ndodh me këto viktimat të pandihmuara në një afat kohe të gjatë? A ka dallime sistematike midis viktimave të ndihmuara dhe të pandihmuara? A kanë nevojë viktimat e pa ndihmuara për lloje të ndryshme të ndihmës nga ajo që është në dispozicion?

Dhënia e burimeve të mjaftueshme

Shumë ofrues shërbimesh luftojnë me fonde të pamjaftueshme. Shpesh, nevojat e viktimës (dhe të vartësve të tyre) i tejkalojnë burimet e disponueshme. Programet duhet të kenë buxhete, që i lejojnë për të plotësuar këto nevoja në mënyrë të tillë, që të parandalojnë viktimat të dalin jashtë ndihmës. Në të njëjtën kohë, organizatat duhet të eksplorojnë gjithnjë e më shumë financime të tjera përveç donatorëve ndërkombëtar kundrejt ofrimit të qëndrueshëm të ndihmës dhe shërbimeve të ri-integrimit - për shembull, të bashkërendojnë dhe t'u referohen shërbimeve shtetërore sociale, të kenë akses ndaj shërbimeve të financuara nga shteti (p.sh. kujdesi mjekësor, ndihma financiare, ndihma ligjore) të kenë akses ndaj fondeve shtetërore apo kontributeve në natyrë (strehëza, ambiente zyre), etj.

Merr në konsideratë familjen në dhënien e ndihmës

Familja ka ndikime të rëndësishme dhe që mund të ndryshojë vendimet për refuzimin e ndihmës. Duke përfshirë familjen në ndihmë mund të lehtësojë modelet e refuzimit pasi një arsye e refuzimit ishte nevoja për t'u kthyer dhe mbështetur familjen. Duke i lejuar viktimat të sjellin fëmijët e tyre (ose vartës të tjerë) në programet e ndihmës është po aq e rëndësishme. Megjithatë, kjo duhet bërë në mënyra që ofrojnë kujdesin e mjaftueshëm brenda burimeve ekzistuese dhe që të mos jetë shqetësuese për përfitueset e tjera, për shembull në ambientet e strehëzës. Përfshirja e anëtarëve të familjes mund të ndihmojë

gjithashtu për të lehtësuar mosbesimin e familjeve për vërtetësinë e ndihmës, edhe pse kjo duhet bërë në mënyrë të tillë që të mos shkelë konfidencialitetin.

Zhvillo programe që janë jo-identifikuese dhe jo-stigmatizuese

Ndihma ndaj viktimave të trafikimit mund të jetë më pak stigmatizuese nëse është e integruar, në një shkallë të madhe, me përpjekjet për ndihmë sociale, me qëllim që ndihma e ofruar të jepet në bazë të cënueshmërisë shoqërore sesa si shkak i të qënurit një viktimë trafikimi. Kjo qasje, për shembull ofrimi i shërbimeve ndaj grave të papuna ose të varfra në komunitet, ka të ngjarë të ketë një farë suksesi në arritjen e viktimave, që prindërshe nuk do ta kishin pranuar ndihmën.

Merr në konsideratë modele dhe metoda alternative ndihme

Kjo lloj ndihme dhe se si ofrohet, duhet të marrë parasysh jetën dita-ditës dhe detyrimet e personave të trafikuar kur të kthehen. Ndihma që nuk përfshin qëndrimin në një strehëz qendrore (dhe kështu, largohen nga familja apo komuniteti) mund të jetë një alternativë e mirë për shumë viktimë që nuk janë në gjendje të lenë prindërit ose fëmijët, ose që nuk mund t'ia dalin të mos kenë të ardhura ndërkohë që marrin ndihmën.

Harto dhe zhvillo programe për “profile” të tjera të viktimave

Viktimat që refuzojnë ndihmën janë në situata të ndryshme dhe kanë karakteristika të ndryshme nga ato që e pranojnë ndihmën. Shumë viktimë e kanë pranuar ndihmën vetëm kur janë përballur më një situatë të dëshpëruar dhe nuk kanë alternativa të tjera. Anasjelltas, njerëzit që kishin alternativa, (p.sh. të shkonin në shtëpi tek familja) në përgjithësi e refuzuan ndihmën e posaçme të pas-trafikimit si dhe kërkuan mbështetje formale si dhe jo formale diku tjetër. Kjo do të thotë se disa nga karakteristikat që lidhen me viktimat e trafikimit mund të jenë më përfaqësuese për viktimat e ndihmuara të trafikimit. Por duhet të hartohen programe edhe për të plotësuar nevojat e këtyre, deri më tani, viktimave të pandihmuara.

Ta lësh të kaluarën mbrapa? Kur viktimat e trafikimit refuzojnë ndihmën



P.O.Box 2947 Tøyen
N-0608 Oslo
www.fafo.no/english/

Fafo-report 2012:32
ISBN 978-82-7422-903-7 (paper edition)
ISBN 978-82-7422-904-4 (web edition)
ISSN 0801-6143